

Koha

E përditshme informative Viti XI • Numri 3185 • E shtunë 30 shtator/e diel 1 tetor 2017 15 DEN



Të gjithë për zgjedhje pa incidente

Shkup, 29 shtator - Organizmi i zgjedhjeve të lira fer dhe kredibile dhe me rezultate të njohura nga të gjitha palët, do të jetë sfida e radhës jo vetëm për Komisionin Shtetëror Zgjedhor, që ka barrën kryesore të organizimit të zgjedhjeve, por edhe për Qeverinë e re të

Zoran Zaevit. Pikërisht për organizimin e zgjedhjeve pa incidente të premtën u prononcua edhe ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski. "Më shumë se 10 mijë policë janë në trajnim me pjesëmarrje të OSBE-së për zgjedhjet lokale, ndërkaq për MPB -

prioriteti bazë janë zgjedhjet korrekte dhe demokratike", theksoi Spasovski. Ministri i Policisë kërkoi po ashtu bashkëpunimin me partitë politike që të ketë, siç tha ai, proces zgjedhor demokratik në vend. "Asnjë person zyrtar që punon në polici..."

FAQE 3

Tregu i Bit Pazarit përplot specatë kuq, por blerës s'ka

A po bëhet ajvari ushqim luksoz!



Shitësit në tregun më të madh në Shkup - në Bit Pazar, thonë se nga viti në vit ulen kërkesat për përgatitjen e turshive edhe pse në treg ka shumë specatë kuq, ka edhe blerës - por jo dhe shitje. Sipas shitësve, nëse vite më parë brenda ditës shisnin mbi 1000 kilogram specatë, tani ndodhë që brenda ditës më shumë që mund të shesin është 100 kilogram

FAQE 4

GLOBI

Spastrimi etnik largoi 84 për qind të muslimanëve



Mbi 80 për qind e muslimanëve të Arakanit të cilët që nga vitet e 70-ta i janë nënshtruar tiranisë dhe shtypjeve sistematike në Mianmar, kanë braktisur trojet e tyre në këtë vend dhe kanë migruar në shtetet...

FAQE 17

SPORT

KB Shkupi zyrtarisht pjesë e Ligës së parë

FAQE 19

GLOBI

Urrejtja, BE u jep ultimatum mediave sociale

FAQE 17



TELESHIKUES TË NDERUAR...KANDIDATË TË KËTILLË NA DUHEN...



KY ËSHTË MAGJIËSTARI I NJË CIRKU TË FAMSHËM... BËN ÇUDIRA...!



Tre ditë nga ndërprerja e protestës

S'ka ende orar për studentët e UT-së në Shkup



Koha | Laura PAPANIKU

Shkup, 29 shtator - Protesta e studentëve të Universitetit të Tetovës në Shkup u ndërpre që të martën pasdite, por pavarësisht kësaj, nuk ka pasur ligjërata gjatë ditëve në vijim. Të paktën, deri të premten, në asnjërin prej gjashtë programeve të disperzuara të UT-së nuk kishin nisur ligjëratat për vitin akademik 2017/2018, pasi që për të njëjtët nuk ishte përgatitur akoma orari përkatës. Viti, sipas të gjitha gjasave, pritet të nisë të hënën, më 2 tetor.

"Na kanë premtuar se këto ditë do të përgatisin orarin e ligjëratave dhe shpresojmë që deri të hënën të jetë zgjidhur edhe ky problem", thotë Enes Sherifi, kryetar i Këshillit nismëtar kundër shpërnguljes së studimeve të disperzuara nga Shkupi në Tetovë. E rëndësishme është që studentët ia dolën të ndalin shpërnguljen e mundshme të programeve të disperzuara, kurse puna e orarit, e cila gjithashtu është mjaft e rëndësishme për mbarëvajtjen e studimeve, thotë se është çështje ditësh.

Pas sensibilizimit të problemit që kishte të bëjë me ten-

dencën e shpërnguljes së studentëve të programeve të disperzuara në UT dhe pas reagimit të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës (MASH), UT-ja u detyrua të mbyll këtë çështje në favor të kërkesave të studentëve. Pra, të pranohet detyrimin për të organizuar studime për të gjitha grupet me mbi 20 studentë në qytetet ku edhe janë regjistruar ato studentë. Konkretisht MASH kujtoi UT-në se është detyruar të respektojë konkursin mbi bazën e të cilave janë hapur programet studimore në Shkup dhe qytete të tjera dhe menjëherë pas kësaj, UT ka dalë me njoftimi se studentët do të vijojnë të mësojnë aty ku edhe kanë filluar studimet. Në të kundërtën, UT do të bënte shkelje të ligjeve për arsim të lartë, sipas të cilave nuk mund të behet transferimi i asnjë grupi të studentëve pa dëshirën e tyre. Plus që gjashtë nga shtatë programet e disperzuara në Shkup, kanë më tepër se 20 studentë. "Bëhet fjalë për grupe të mëdha studentësh me nga 30 deri 60 studentë", tregon Sherifi. Vetëm një grup është detyruar të transferohet në Shkup, konkretisht


grupi studentëve të filozofisë pasi ishin 13 studentë, sqaron ai.

Meqë, në dy vitet e kaluara UT nuk ka pasur konkurs për programet e disperzuara në Shkup, këtu kanë mbetur vetëm studentët e vitit të tretë dhe të katërt. Duke përjashtuar grupin e filozofisë, në hapësirat e Shkollës "Kongresi i Manastirit", të vënë në dispozicion të studimeve, këtë vit akademik (2017/2018) do të janë programet studimore të gazetarisë, ekonomisë, administrimit biznesit, juridikut dhe ekologjisë. Sherifi, nga Këshillit nismëtar kundër shpërnguljes së studimeve të disperzuara nga Shkupi në Tetovë, insiston në pohim se janë rreth 570 studentë. "Jemi shumë të sigurt se numri i studentëve është ky, pasi informacionet i kemi zyrtare, të siguruar nga administrata e UT-së", pohon ai, duke sqaruar se këtij numri mund t'i hiqen vetëm 13 studentë e filozofisë, të cilët meqë ishin më pak se 20, janë të detyruar të shpërngulen me studimet e tyre në Tetovë. Ditë më parë, kur studentët e kishin bllokuar hyrjen në hapësirat SHF "Kongresi i Manastirit" në shenjë proteste

Viti akademik për studentët e UT-së në Shkup, sipas të gjitha gjasave do të nis të hënën, më 2 tetor, pasi gjatë këtyre ditëve, UT-ja nuk kishte përgatitur ende orarin e ligjëratave për ta. "Na kanë premtuar se këto ditë do të përgatisin orarin e ligjëratave dhe shpresojmë që deri të hënën të jetë zgjidhur edhe ky problem", thotë Enes Sherifi, kryetar i Këshillit nismëtar kundër shpërnguljes së studimeve të disperzuara nga Shkupi në Tetovë

për shpërnguljen e mundshme të tyre dhe kur një ditë para kësaj kishin dorëzuar në Rektoratin e UT-së peticionin me 422 nënshkrime, zyrtarë të UT-së hodhën dyshime mbi vërtetësinë e këtyre numrave. Prorektori për çështje arsimore, Reshat Qahili, tha se këto numra duhet të merren me rezervë, pasi, sipas tij, nuk bëhet fjalë për numër kaq të madh studentësh. Në Shkup, sipas s Qahilit, mund të jenë maksimumi 250 studentë, pasi një vit përpara në programet e disperzuara të UT-së kishte 214 studentë, sqaronte ai.

Mirëpo, këto pretendime hidhen poshtë nga Këshillit nismëtar kundër shpërnguljes së studimeve të disperzuara nga Shkupi në Tetovë, e sipas të cilit të gjithë të nënshkruarit në peticion janë studentë, ndërsa numri i saktë i atyre që kanë regjistruar semestrin dimëror të vitit akademik 2017/2018 në Shkup, është rreth 570 studentë.



Edhe një akuzë huliganin Igor Jug

Shkup, 29 shtator - Igor Jug, njëri prej dhunuesve kryesor të 27 prillit, të premten i është caktuar masë e re e sigurisë, kësaj radhe gjykatësi në procedurë paraprake të akuzuarit në fjalë i ka shqiptuar masën e paraburgimit 30 ditor. Ky vendim i gjykatës ka pasuar pasi i akuzuari Igor Jug, banor i Kumanovës, i kaloi 8 ditë në burgun e Shutkës, ndërkohë të premten - pasi është marrë në pyetje nga Prokuroria Publike, ndaj tij është ngritur edhe një akuzë tjetër, kësaj radhe si i dyshuar për "udhëheqjen e masës që ka operuar dhunshëm në Parlament". Në prononcimin zyrtar të Prokurorisë Publike, thuhet se deri të Gjykata Penale e Shkupit është parashtruar propozim akuzë për të dyshuarin, pasi nga hetimet e deritanishme - janë zbuluar dëshmi të reja. "Nga provat e siguruar deri më tani, është konstatuar se krahas veprës penale 'armë mbajtje pa leje', ekzistojnë dyshime bazë se i akuzuari ka ndërmarre veprime si udhëheqës i masës gjatë kohës kur ato janë futur dhunshëm në Parlament më 27 prill të këtij viti. Për këto shkaq, prokurori e miratoi vendim për fillimin e procedurës hetimore edhe për veprën penale 'pjesëmarrje në masë', që kryen veprën penale e për të cilën është caktuar dënimi nga 1 deri në 10 vite heqje lirie", thuhet në njoftimin e Prokurorisë Publike. Në arsyetimin e shqiptimit të masës së re prej 30 ditë paraburgim, nga Prokuroria thonë se ky vendim është marrë për arsye se ekziston rreziku nga arratisja, pengimimi i hetimeve dhe përsëritja e veprës nga i akuzuari Igor Jug. Ndryshe, arrestimi i të akuzuarit ndodhi me datë 21 shtator, disa muaj pas dhunës së ushtruar në Parlament, me çka policia e shtetit që atëherë i ishte vënë në kërkim, megjithatë arrestimi i tij ndodhi pas disa muaj kërkime.

Xhaferi priti në takim Dautogllun

E rëndësishme mbështetja turke

Shkup, 29 shtator - Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, të premten priti në takim ish-kryeministrin e Qeverisë të Republikës së Turqisë dhe deputet aktual nga Konja, Ahmet Davutogllu. Siç kumtuuan nga shërbimi parlamentar për informim, të dyja palët shprehën kënaqësi të madhe nga marrëdhëniet e përgjithshme politike maqedonase - turke të cilat janë në nivelin më të lartë të mundshëm dhe janë në frymën e miqësisë tradicionale, mirëkuptim-

it të ndërsjellë, tolerancës dhe bashkëpunimit aktiv. Bashkëbiseduesit në takim theksuan se marrëdhëniet veç më të vendosura intensive hapin hapësirë për një bashkëpunim edhe më aktiv ekonomik. Republika e Turqisë është partner i rëndësishëm tregtar i Republikës së Maqedonisë ndërsa bashkëpunimi ndërmjet dy shteteve në të gjitha fushat është gjithashtu i suksesshëm dhe karakterizohet me trend pozitiv dhe vazhdimësi. Bashkëbiseduesit u pajtuan se përveç

miqësisë së fortë dhe bashkëpunimit të frytshëm, të dy vendet i ndërlidhin edhe lidhjet e ngushta historike dhe kulturore, marrëdhëniet e mira dhe miqësore ndërmjet dy vendeve pasqyrohen edhe në bashkëpunimin e frytshëm parlamentar në nivelin bilateral, ndërmjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Asamblesë së Madhe Nacionale të Republikës së Turqisë, por edhe në nivel multilateral, në kuadër të asambleve parlamentare ndërkombëtare. Gjatë takimit u sh-

preh mirënjohje për përkrahjen konsekuente dhe konstruktive të Turqisë dhe për solidarizimin me Maqedoninë në kuadër të integriteteve euroatlantike. "Duke iu referuar përcaktimit tonë strategjik, Xhaferi theksoi se është veçanërisht e rëndësishme përkrahja e hapur dhe e fuqishme e Republikës së Turqisë për integrimin e Republikës së Maqedonisë në NATO, si edhe qëndrimet parimore të Republikës së Turqisë në raport me përdorimin e emrit kushtetues të vendit tonë", thuhet në kumtesën



e Parlamentit të Maqedonisë. Bashkëbiseduesit shprehën shpresë se bashkëpunimi i mirë ndërmjet dy vendeve do të vazhdojë edhe më tutje.



KSHZ të dielën nënshkruan Listën zgjedhore

Të gjithë për zgjedhje pa incidente

Sa i përket vëzhguesve të huaj, Arjeta Xhemaili nga KSHZ thotë se përveç OSBE-ODHIR-it, prezent në monitorimin zgjedhjeve do të jetë edhe Këshilli Evropian, shtetet fqinje dhe ato të Evropës. Në ndërkohë, ministri i MPB-së, Oliver Spasovski ka thënë se më shumë se 10 mijë policë janë në trajnim me pjesëmarrje të OSBE-së për zgjedhjet lokale, ndërkaq prioriteti bazë, siç u shpreh ai, janë zgjedhjet korrekte dhe demokratike



Spasovski. Ministri i Policisë kërkoi po ashtu bashkëpunimin me partitë politike që të ketë, siç tha ai, proces zgjedhor demokratik në vend. "Asnjë person zyrtar që punon në polici nuk ka të drejtë të marrë pjesë në asnjë fushatë elektorale partiake. Ministria e Punëve të Brendshme është e gatshme për të gjitha përgatitjet e një procesi të mirëfilltë, pra ne kontribuojmë që të ulen incidentet që të prishin procesin zgjedhor", tha ministri i MPB-së, Oliver Spasovski. Nga ana tjetër, KSHZ është në vllugun e punëve jo vetëm në aspektin teknik të përgatitjes së materialeve zgjedhore, por edhe në aspekt të edukimit të komisionerëve dhe përmbyllës së Listës zgjedhore. "KSHZ është e interesuar që zgjedhjet në aspekti teknik të mos kenë asnjë

mangësi dhe procesi të kalojë sipas Ligjit. Për momentin po merremi me përgatitjen e materialeve zgjedhore, meqë këto janë zgjedhje lokale dhe fletëvotimet janë më të komplikuar, sidomos ato për këshilltarë komunal po punojmë që ata të jenë sa më të pranueshme dhe të lexueshme qartë për qytetarët. Lista zgjedhore do të jetë me foto për çdo votues dhe e cila pritet të nënshkruhet 15 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, do të thotë këtë të diel. Deri më tani i kemi kompletuar të gjitha këshillat zgjedhore dhe komisionet komunale", tha Arjeta Xhemaili, zëdhënëse e KSHZ-së. Siç njofton ajo, më tej partitë politike duhet që pas dhjetë ditëve të fushatës zgjedhore, të dërgojnë në KSHZ raport financiar lidhur me paratë që kanë harxhuar gjatë

fushatës dhe të tregojnë donacionet nga jashtë partisë. "Nga e hëna do të fillojmë me procesin edukues të komisionerëve në Këshillat zgjedhore, ndërsa fushata edukuese do të vlejë edhe për qytetarët përmes spoteve televizive dhe sendeve të shtypura për të drejtat e tyre zgjedhore", tha Xhemaili. Sa i përket vëzhguesve të huaj, Xhemaili thotë se përveç OSBE-ODHIR-it, prezent në monitorimin e zgjedhjeve do të jetë edhe Këshilli Evropian, shtetet fqinje dhe shtete tjera të rajonit dhe Evropës. "Nga vendorët do të kemi dy rrjete të organizatave - organizatën 'Civil' dhe 'Most'. Vëzhgues kemi pranuar edhe nga Këshilli Evropian përveç OSBE-ODHIR-it, ndërsa edhe shtetet fqinje si Shqipëria dhe shtetet tjera të rajonit dhe Evropës kanë lajmëruar se do të

kenë monitorues në këto zgjedhje", tha Xhemaili. Në ndërkohë, nga partitë politike, Aleanca Shqiptare ka qëndrime kritike ndaj Gjykatës Administrative, e cila e ka vlerësuar si të pabazë kërkesën e kësaj partie që të hiqet emërtimi "Aleanca për Shqiptarët" i koalicionit të dy partive - RDK dhe UNITETI. Të njëjtën kërkesë kohë më parë nuk e pranoi as vetë Komisioni Shtetëror Zgjedhor. "Vendimi skandaloz i Gjykatës Administrative që e vlerësoi si të pabazë kërkesën e Aleancës për Shqiptarët ndaj emërtimit të ngjashëm të koalicioni RDK dhe Uniteti, si dhe neglizhencën e KSHZ-së ndaj këtij fenomeni dashakeq për të krijuar konfuzion tek votuesi, flet shumë dhe më këtë - procesi zgjedhor nuk lë shumë për të dëshiruar. Instalimi i gjykatësve politik të BDI-së dhe VMRO-së po mundohet shpeshherë dhe është në shërbim të subjekteve që janë propozuar dhe jo në mbrojtje të Ligjit dhe normave Juridike. Kjo është një dëshmi se Gjykatat urgjentisht duhet reformuar dhe zhveshur nga petku partiak politik", thotë Flakron Bexheti nga Aleanca për Shqiptarët. Ai fton KSHZ-në që të jetë e kujdesshme në kryerjen e punës së saj gjatë procesit zgjedhor. "KSHZ duhet të jetë u kujdesshme dhe ta bëjë punën e saj me profesionalizëm dhe paanshmëri në interes të një procesi sa më profesional,

demokratik dhe transparent. Kur jemi tek mbarëvajtja e rregullt e zgjedhjeve, KSHZ të premtën u kërkoi komunave të ndalojnë të gjitha aktivitetet për organizimin e referendumeve lokale për emigrantët deri në vendimin që do të japë Gjykata Kushtetuese. "Të ndalohen të gjitha aktivitetet për përgatitjen dhe organizimin e referendumeve lokale për emigrantët deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese" bën të ditur KSHZ. Ky është mesazhi i dërgon nga KSHZ për komunat Koçan, Shtip, Gjevgjeli, Kavadar, Negotinë, Veles, Manastir, Prilep, Radovish, Ohër, Aerodrom dhe Gazi Babë, vendimet e të cilëve u ndaluan nga Inspektorati për Vetëqeverisje Lokale. Për Karposhin dhe Gjoçe Petrovin, të cilët më vonë morën vendime të njëjta, si dhe për Debarcën, e cila njofton një referendum mbi një deponi të mbeturinave të ngurta, dilema është nëse ai mund të jetë në të njëjtën ditë me zgjedhjet lokale. Nga VMRO kanë kritikuar Qeverinë se po bën presion ndaj KSHZ-së që të parandalojë mbajtjen e referendumeve lokale për emigrantët. "Me të gjitha mundësitë, Qeveria e LSDM-së po bën presion mbi KSHZ-në që të parandalojë mbajtjen e referendumeve lokale për emigrantët. KSHZ-ja patjetër duhet sipas Ligjit t'u mundësojë qytetarëve që ta tregojnë mendimin e tyre", theksoi djmë Bojan Stojanovski nga VMRO.

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 29 shtator - Organizmi i zgjedhjeve të lira fer dhe kredibile dhe me rezultate të njohura nga të gjitha palët, do të jetë sfida e radhës jo vetëm për Komisionin Shtetëror Zgjedhor, që ka barrën kryesore të organizimit të zgjedhjeve, por edhe për Qeverinë e re të Zoran Zaevit. Pikërisht për organizimin e zgjedhjeve pa incidente të premtën u prononcua edhe ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski. "Më shumë se 10 mijë policë janë në trajnim me pjesëmarrje të OSBE-së për zgjedhjet lokale, ndërkaq për MPB - prioriteti bazë janë zgjedhjet korrekte dhe demokratike", theksoi



Kasami takohet me kryeministrin e Turqisë

Shkup, 29 shtator - Kryetari i Lëvizjes Besa dhe njëkohësisht kandidat për kryetar të Komunës së Tetovës, Bilall Kasami ka udhëtuar drejt Turqisë ku ka zhvilluar një takim me kryeministrin turk, Binali Yldirim. Delegacioni i lartë i Lëvizjes Besa i kryesuar nga kryetari Bilall Kasami, i shoqëruar nga Asaf Ademi, kandidat për komunën e Gostivarit, ishin të ftuar special të kryeministrit të Turqisë, Binali Yldirim në ceremoninë e hapjes së terminalit të ri

të aeroportit të Çanakalāsë. "Kjo ishte një mundësi e mirë që me kryeministrin e Turqisë të bashkëbisedojmë për zhvillimet e fundit në Maqedoni si dhe për përkrahjen e vazhdueshme të Turqisë për shqiptarët e Maqedonisë. Kryeministri vlerësoi kontributin e Lëvizjes Besa, si një lëvizje e re politike, e cila në mënyrë dinjitoze përfaqëson shtresën e re intelektuale të shqiptarëve të Maqedonisë", deklaroi kryetari i Lëvizjes BESA, Bilall Kasami.

Ahmeti në Haraçinë

Përballuam çdo stuhi dhe nuk ju zhgënjëm

Shkup, 29 shtator - Kandidati për postin e kryetarit të komunës së Haraçinës, Isuf Bislimi, të enjten mbrëma para anëtarëve dhe simpatizantëve të BDI-së, tha se me fitoren në zgjedhjet e 15 tetorit Haraçina do të dalë nga grupi i komunave të varfra, përmes çuarjes përpara të projekteve të ndërmarra nga qeverisja e deritanishme vendore dhe realizimi i projekteve të tjera. Bislimi përmendi këtu projekte që lidhen me sigurimin e ujit të pijshëm, rregullimin e gjithë infrastrukturës, investimeve në rrjetin e shkollave, për një mjedis më të shëndetshëm apo edhe kujdesit për familjet e dëshmorëve. Ndërkaq, duke marrë fjalën, kryetari i Bashkimit Demokratik për Integritim, Ali Ahmeti, tha se BDI-ja ka ndërtuar vlera komfaktare, por mbi të gjitha ka pasur për angazhimin ndërtimin e vlerave njerëzore, me kapacitete e mirë të përgatitur për t'u vënë



në shërbim të njerëzve, në shërbim të së ardhmes. "Mendojmë që ne nuk ju kemi zhgënjyer. Ne e dimë se kemi për të bërë edhe shumë punë, sepse hallet tona nuk kanë qenë edhe aq të vogla. Punët përpara nesh nuk kanë qenë aq edhe të lehta, por ama qëllimin e kemi pasur shumë të mirë dhe shumë fisnik dhe me zemër kemi punuar që të mos zhgënjëm bashkëkombasit tanë, të mos i zhgënjëm ata që na besuan këto procese të rëndësishme që nga 2002

e deri tash më 2017", tha Ahmeti. Duke rikujtuar krizën politike të para dy vjetëve ai nënvizoi se autorët e saj synonin pikërisht dëmtimin e Bashkimit Demokratik për Integritim, si forcë e vetme e dalë nga një rezistencë shumë e organizuar dhe e fuqishme e popullit shqiptar në Republikën e Maqedonisë "Pse i gjithë ky sulm, pse e gjithë kjo stuhi? Sigurisht që po të lësh gjurmë të këqija, apo sikurse thonë me gjuhën e intelektualëve, të histori-

anëve - hipoteka, sigurisht që nuk mund të lëvizësh, por ama, ne me devotshmëri kemi hyrë që të punojmë dhe të çojmë përpara çështjet. Kjo stuhi kaloi dhe unë do të kërkoj nga ju, si njeri i juaji që të mos ketë pasoja" u shpreh Ahmeti. Duke u përqëndruar në zgjedhjet e 15 tetorit, ai uroi që ato në Haraçinë të jenë të lira e të ndershme, pa frikësime, të jenë demokratike "Le të ketë gara, sepse njerëzit në një mendje nuk mund t'i bëjmë, por edhe të gjithë nuk kanë kontribuar njësoj për ditët që jetojmë sot dhe përgjegjësinë më të madhe e kanë për këtë vend ata që kanë dhënë edhe gjak, edhe djersë. Prandaj ne jemi edhe të mëdhenj dhe i thërrasin të gjithë të vijnë me ne, se ne Haraçinës keq nuk i kemi bërë. Haraçinën bashkë e kemi futur në histori, dhe bashkë në histori Haraçinën duhet ta mbajmë!", tha Ahmeti në shpalosjen e ofertës zgjedhore në Haraçinë.



Çmimi i shitjes me pakicë i energji elektrike, më i ulët se vjet

Shkup, 29 shtator - Në gjashtë muajt e parë të vitit çmimi mesatar me pakicë i energjisë elektrike për amvisëritë ka qenë 5017 denarë për kilovat orë, që paraqet ulje prej 1.3 për qind në krahasim me gjysmë vjetorin e dytë në vitin 2016. Çmimi mesatar i shitjes me pakicë i gazit natyror për amvisëritë për periudhën e njëjtë arrin 31.464 denarë për metër kub normal. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, çmimi mesatar i energjisë elektrike pa tatim të vlerës së shtuar për konsumatorët finalë, përveç amvisërive, lëviz prej 3.417 deri në 8.084 denarë për kilovat orë sipas grupeve të konsumatorëve. Çmimi mesatar, megjithatë, i gazit natyror pa tatimin e vlerës së shtuar për konsumatorët finalë, përveç amvisërive, lëviz prej 15.709 deri në 22.673 denarë për metër kub normal sipas grupeve të konsumatorëve.

Ekspertët zviceranë ndihmojnë kompanitë vendore

Shkup, 29 shtator - Pesë kompani vendore, të industrisë ushqimore, të tekstilit, të industrisë metalike, do ta avancojnë punën me këshilla falas prej pesë ekspertëve nga Zvicra, si pjesë e thirrjes së tretë për projektin qeveritar "Angazhimi i ekspertëve seniorë për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Maqedoni". "Projekti për mbështetjen e kompanive të vogla me ndihmën e ekspertëve nga jashtë u tregua si efikas dhe për këtë u publikua thirrja e tretë në të cilën janë dorëzuar 35 aplikacione", informoi të premten zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev në nënshkrimin e deklaratës për pëlqim për bashkëpunim në projektin me ambasadorin e Zvicrës në Maqedoni, Sibil Suter Tehada. Në dy vitet e kaluara, theksoi Angjushev, ndihmë prej ekspertëve kanë marrë 96 kompani, ndërsa anketat tregojnë se 90 për qind janë të kënaqur prej këtij projekti, ndërsa 70 për qind përsëri do të aplikojnë. Ambasada zvicerane i mbulon mbi 90 për qind të shpenzimeve për angazhimin e ekspertëve, ndërsa në projekt janë kyçur edhe ekspertë nga Austria, Holanda dhe Gjermania.

Shitësit në tregun më të madh në Shkup - në Bit Pazar, thonë se nga viti në vit ulen kërkesat për përgatitjen e turshive edhe pse në treg ka shumë specja të kuq, ka edhe blerës - por jo dhe shitje. Sipas shitësve, nëse vite më parë brenda ditës shisnin mbi 1000 kilogram specja, tani ndodhë që brenda ditës më shumë që mund të shesin është 100 kilogram

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 29 shtator - Kanë mbetur edhe shumë pakë ditë që qytetarët të mund të bëjnë në kohë përgatitjet e turshive për dimër, e në veçanti bërjen e ushqimit tradicional dimëror - ajvarin. Tregu i gjelbër në Bit Pazar është përplot me specja të kuq, mirëpo sipas tregtarëve - shitja e specave të kuq është shumë i vogël. Tregtarët ankohen se nga viti në vit po zvogëlohen shitja e specave të kuq, ndërsa qytetarët thonë se çmimi për një kilogram specja të kuq nuk është aq i lartë, por arsyeja se pse ata blejnë më pak sasi të specave të kuq është se nuk kanë buxhet të mjaftueshëm familjar për të blerë sasi më të mëdha specave të kuq. Zulqulli Qaili nga fshati Paligrad, shitës në tregun më të madh me shumicë në Shkup - Bit Pazarit, thonë se nga viti në vit ulen kërkesat e perimeve për përgatitjen e turshive. "Në treg ka shumë specja të kuq, ka edhe blerës, por jo dhe shitje. Nëse vite më parë brenda ditës shisja mbi 1000 kile specja, tani ndodhë që brenda ditës më shumë që mund të shesë është 100 kilogramë. Ndonjëherë ndodhë që gjithë ditën të shesë një kuti specja deri më 20 kilogramë", thotë Qaili. Sipas tij, kërkesat e qytetarëve për blerjen e specave të kuq për përgatitjen e ajvarit nga viti në vit po ulen. "Për dallim nga viti i kaluar, mendoj se sivjet për 20 për qind më pak kemi shitje të specave të kuq. Çmimi prej 30 denarë për një kilogram

Tregu i Bit Pazarit përplot specja të kuq, por blerës s'ka

A po bëhet ajvari ushqim luksoz!



specja nuk është arsyeja se pse qytetarët blejnë më pak specja. Në Bit Pazar për të blerë vijnë pensionistë dhe familje që janë me ndihma sociale. E këta nuk kanë para që të blejnë më shumë specja, por blejnë aq sa kanë para. Ndërsa ata që kanë para, nuk vijnë të blejnë në Bit Pazar, por shkojnë në Strumicë dhe blejnë specat e kuq. Siç po shkon shitja kaq e vogël e specave, si duket ajvari po bëhet ushqim luksoz", thotë Zulqulli Qaili. Qytetarët të cilën jo në numër të vogël po tentonin të bënin pazar me shitësit që të ulnin çmimin e specave, thonë se në bazë të cilësisë - çmimi prej 30

denarëve nuk është dhe aq i lartë, mirëpo për shkak se tanimë po hyjmë në sezonin e dimrit, ku përveç turshive - nevojiten edhe gjëra të tjera, buxheti i tyre nuk lejon një luks që të marrin sasi më të mëdha të specave, por blejnë aq sa kanë para. "Ka llogari si jo. Çmimet nuk janë dhe aq të larta, ja specat janë shumë të mirë, sepse 30 denarë për kilogram me këto specja mund të bësh ajvar shumë të mirë. Ai që ka para, ka llogari të blejë më shumë kilogram, e ne që nuk kemi para - nuk kemi llogari të blejmë më shumë kile specja", tha një qytetar, pasi nuk arriti të merrej vesh me shitësit që të

paktën - një kilogram specja t'ja shesë për 28 denarë. Përndryshe, që të përgatisni të paktën dhjetë kavanoz ajvar, është e nevojshme të blihi të paktën 50 kg specja, dhe për këtë duhet të ndahen rreth 1500 denarë. Së bashku me përbërësit e tjerë për përgatitjen e ushqimeve, nevojiten 1700 denarë plus energji elektrike ose dru për përgatitjen e tij, pa e llogaritur fuqinë punëtore. Nëse në këtë matematikë shtoni edhe përgatitjen e turshive dhe disa ushqimeve të tjera, përafërsisht çdo familje duhet të ndajë të paktën njëqind euro për të përgatitur turshinë e dimrit.

Bëhet sistemimi paraprak i linjave të autobusëve

Shkup, 29 shtator - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve sot bëri sistemim paraprak të linjave të reja ose ndryshimin e linjave ekzistuese të autobusëve për vitin 2017. Në bazë të sistemimit paraprak, prej gjithsej 27 aplikacioneve

të dorëzuara për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve janë miratuar 14, një pjesërisht është miratuar, ndërsa 12 janë refuzuar. Për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve, nga ana tjetër, nga 51 aplikacione të

dorëzuara janë miratuar 28, tre janë miratuar pjesërisht, ndërsa 20 janë refuzuar. "Sistemimi i linjave të autobusëve bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në Ligjin për transportin në komunikacionin rrugor dhe akteve nën-

ligjore", thuhet në kumtesën e Ministrisë për Transport dhe Lidhje. Informacionet e plota për sistemimin preliminar të linjave janë në dispozicion në ueb faqen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve www.mtc.gov.mk.

Raporti i OBSH-së

Ajri i ndotur po u shkurton jetën qytetarëve

Nga vendet e tjera të rajonit, duket se Shqipëria po i rrezikon më pak jetën banorëve sa i përket ndotjes, ndërsa në Kosovë do të kishim 0.37 jetë/person, Serbi 0.73 jetë/person, Maqedoni 0.59 jetë/person dhe Mali i Zi 0.26 jetë/person

Shkup, 29 shtator - Ndotja e ajrit është rreziku më i

madh për shëndetin mjedisor për njerëzit, thotë Organizata Botërore e Shëndetësisë, por si përket ndotjes, ndërsa në Kosovë do të kishim 0.37 jetë/person, Serbi 0.73 jetë/person, Maqedoni 0.59 jetë/person dhe Mali i Zi 0.26 jetë/person. Sipas këtyre të dhënave, shqiptarët do të jetonin 0.23 vite jetë/person më shumë nëse vendi do të reduktohej ndotjen e ajrit në përputhje me standardin e

OBSH-së. Nga vendet e tjera të rajonit, duket se Shqipëria po i rrezikon më pak jetën banorëve sa i përket ndotjes, ndërsa në Kosovë do të kishim 0.37 jetë/person, Serbi 0.73 jetë/person, Maqedoni 0.59 jetë/person dhe Mali i Zi 0.26 jetë/person. Shkencëtarët konkluduan se jetëgjatësia e jetës zvogëlohet për rreth shtatë muaj me çdo 10µg/m³ shtesë të PM10 në ajër. "Rezultatet tregojnë rastet kur ekspozimi afatgjatë

ndaj ajrit të ndotur shkakton një reduktim të konsiderueshëm të jetëgjatësisë", tha Michael Greenstone, autor i publikimit dhe drejtor i Institutit të Politikave të Energjisë (EPIC) në Universitetin e Çikagos. Nga një raporti i bërë publik një vit më parë, vëndi ynë rezultonte në një zonë ku ndotja ishte e konsiderueshme, duke marrë në konsideratë matjet e bëra për përpilimin e indeksit të OBSH.





Shkup, 12 aksidente me dy këmbësorë të lënduar

Shkup, 29 shtator - Dy këmbësorë janë lënduar më rëndë në dy nga gjithsej 12 aksidente të regjistruara gjatë ditës së enjte në rajonin e SPB Shkup. Në pesë aksidente lëndime më të lehta kanë marrë nëntë persona, ndërsa në pesë

është shkaktuar dëm material. Gjatë ditës policia rrugore ka zbuluar dhe sanksionuar një numër më të madh të shkeljeve, në mesin e së cilëve pesë shoferë të cilët nuk i kanë respektuar kufizimet e shpejtësisë së lëvizjes, tre

shoferë e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit dhe janë përjashtuar nga komunikacioni, tre shoferë nuk i kanë respektuar semaforët, gjegjësisht kanë kaluar në semafor të kuq, si dhe 22 shoferë të cilët e kanë drejtuar

automjetin pa patentë shoferi, gjegjësisht të paregjistruar. Janë hasur 111 automjete të cilat nuk janë parkuar sipas rregullave. Me ndihmën e automjetit special të karrotrecit, janë hequr 82 automjete.

MPPS miraton masë për punë të dobishme komunale

Mbi 460 të papunë do të japin shërbime sociale

"Me punë të dobishme komunale arrihen dy qëllime, nga njëra anë nxitet punësimi i personave të papunë afatgjatë, ndërsa nga ana tjetër fillojnë serviset e caktuara sociale në nivel lokal të cilat komunat i kanë identifikuar si të nevojshme për qytetarët", tha ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovska



Shkup, 29 shtator - Në gjashtë muajt e ardhshëm 466 persona të papunë afatgjatë do të angazhohen të japin shërbime sociale për qytetarët në 39 komuna, përmes Programit "Punë e dobishme komunale" pjesë e planit të rishqyrtuar operativ qeveritar për punësim për vitin 2017. Shërbime më të shpeshta të cilat do të japin këta persona, për çka kanë vizituar edhe trajnime më adekuate, janë kujdesi dhe mbështetja e personave të moshuar në kushte shtëpie, mbështetja e personave me aftësi të kufizuara, por sivjet për herë të parë përfshihen edhe asistentë edukatorë ose persona të cilët i ndihmojnë personave me aftësi të kufizuara në procesin

arsimor. "Me punë të dobishme komunale arrihen dy qëllime, nga njëra anë nxitet punësimi i personave të papunë afatgjatë, ndërsa nga ana tjetër fillojnë serviset e caktuara sociale në nivel lokal të cilat komunat i kanë identifikuar si të nevojshme për qytetarët", tha ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovska. Ai informoi se për këtë masë ndahen më shumë se 20 milionë denarë nga Buxheti i RM-së, ndërsa mjete shtesë ka siguruar UNDP-ja. Përmasë saj do të angazhohen 466 qytetarë në 39 komuna të përzgjedhura, ndërsa sivjet ka 4 komuna të reja. Personat e angazhuar do të japin

102 shërbime sociale të cilat do të zbatohen me masën. Ministria theksoi se përfshirja e asistentëve arsimorë ose personat të cilët i ndihmojnë personave me aftësi të kufizuara në procesin arsimor, shërbime, që, siç tha, shfrytëzohen 140 persona në 18 komuna, por edhe dhënia e shërbimeve sociale, komunat do ta njohin si të dobishme dhe se do të vazhdojnë të zhvillojnë edhe pas skadimit të zbatimit të kësaj mase. Luiza Uinton nga UNDP-ja e ndan qëndrimin e ministres se arrihen dy qëllime me këtë masë, njëra që të punësohen personat e papunë afatgjatë, ndërsa nga ana tjetër të siguro-

hen edhe shërbime të cilat janë të nevojshme për personat nga grupet e marginalizuara. Në mënyrë shtesë, tha Uinton, masën promovohet edhe barazia gjinore, sepse prej 75 deri në 80 për qind e personave të angazhuar në këtë masë janë gra, por edhe se me shërbimet sociale do të lehtësohet puna e grave në shtëpinë, e cila siç tha Uinton, në pjesë të madhe bie në barë të tyre, siç është kujdesi për shtëpi, fëmijët, pleqtë ose për personat me aftësi të kufizuara. Me masën, është planifikuar të përfshihen, gjegjësisht nevojat që shërbimet sociale t'i marrin rreth 8000 persona në këto 39 komuna.

Kronikë

Aksident me një të vdekur afër Kërçovës

Mëngjesit e së premtes rreth orës 7 e 40 ka ndodhur një aksident trafiku në magjistrale A2 Kërçovë-Gostivar, në afërsi të fshatit Trapçin Doll, ku veturë e tipit Ford Monedo, me targa të Italisë e drejtuar nga I.I 54 vjeçare, duke lëvizur në drejtim nga Gostivari për në Kërçovë, ka humbur kontrollin dhe ka dalë nga rruga duke goditur një shtyllë betoni. Nga lëndimet e marra jetë ka ndërruar I.I 54 vjeçare nga fshati Oktisi të Strugës, ndërsa I.I dhe A.I 33 vjeçar që të dy nga i njejtë fshat janë dërguar në klinikat e Shkupit. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Padi për drejtorin e Pyjeve të Maqedonisë

Spektori për Punë të Brendshme ka ngritur padi penale ndaj T.I 50 vjeçar, drejtor i Ndërmarrjes Publike Pyjet e Maqedonisë, P.S 59 vjeçar dhe S.H. 61 vjeçar që të tre nga Tetova, për shkak të dyshimeve se drejtori ka kryer veprë penale "keqpërdorim të detyrës zyrtare", i dyti ka kryer veprë penale "punë të pavetëdijshme zyrtare", ndërsa i treti për veprën "shkatërrim të pyjeve" dhe uzurpim të patundshmërisë. Sipas policisë, drejtori së bashku me të dyshuarin e dytë i punësuar si referent, i autorizuar për njësinë Pyjet e Leshnicës, i kanë lejuar personit të tretë si përfaqësues I Pyjeve të Maqedonisë, që të hap rrugë në Leshnicë të epërme, në atarin e fshatit Bozovcë, dhe atë në kundërshtim me njoftimin e Ministrisë së Pylltarisë. Me këtë veprim ata kanë shkaktuar dëm prej 8 milionë denarëve, për shkak se janë prerë shumë dru.

Falsifikon lejen e vozitjes paditet një 51 vjeçari

Spektori për Punë të Brendshme në Tetovë, ka ngritur padi penale ndaj M.A nga fshati Bogovinë, për shkak të dyshimeve se ka kryer veprë penale "falsifikim dhe dokumenteve" dhe "përdorim të dokumenteve me përmbajtje të pavërteta". Sipas policisë, më 15 mars rreth orës 12 e 45 minuta, në rrugën Tetovë-Gostivar, nga ana e pjesëtarëve të Policisë është ndaluar veturë e tipit Folsfagen Kedi", e drejtuar nga i dyshuari, dhe pas kryerjes së lejes së vozitjes është konstatuar se leja e tij e kategorisë B dhe pjesëtarët e Policisë kanë dyshuar se bëhet fjalë për falsifikim. Leja është marrë dhe e njëjta është dërguar në kontroll, dhe është vërtetuar se personi në fjalë nuk ka dhënë provimin. Pas analizave të bëra është konstatuar se e njëjta nuk është origjinale.

Grabitje në një market në Shkup

Tre persona dje kanë kryer grabitje në KAM market në Shkup dhe fizikisht kanë sulmuar dy të punësuar. Njëpunësit policorë dje pasditë pas telefonatës për ishjen e rendit dhe qetësisë publike në "KAM market" në rrugën "Fronti Popullor" (Naroden Front) konstatuan se bëhet fjalë për një grabitje. Tre burra të panjohur, të cilët kanë hyrë në market, kanë marrë disa artikuj ushqimorë, por pasi janë vënë re nga qendra e monitorimit, në të dalë nga marketi janë ndalura nga të punësuarit M.P (34) dhe B.K.(21) ku si pasojë këta persona edhe janë sulmuar fizikisht. Gjatë tentativës për tu larguar njëri prej tyre është ndalur. Bëhet fjalë për K.B. (19) nga Shkupi, i cili është arrestuar në stacionin e policisë Qendër, citon Ministria e Punëve të Brendshme në buletinin e rregullt. Ndërmerren masa për ndriçimin e plotë të rastit.

Shoferi dhe bashkudhëtarja lëndohen rëndë

Shoferi i një automjeti dhe bashkudhëtarja e tij janë dërguar në klinikat e Shkupit me lëndime të rënda trupore, pasi kanë dalë nga korsia në autostradën Tetovë-Gostivar. Sipas informacioneve të SPB Tetovë, aksidenti rrugor ka ndodhur sot rreth orës dy të mëngjesit. Automobili "BMV" që e ka drejtuar J.P. (25) nga Gërçeci i Shkupit, e ka humbur kontrollin dhe ka dalë në fushat përreth, duke u përmbysur disa herë. Në aksident lëndime të rënda ka marrë edhe bashkudhëtarja K.P. (29) nga Berova. Të dy, fillimisht janë mjekuar në sektorin emergjent në spitalin e Gostivarit, prej ku si raste urgjente janë dërguar në klinikat e Shkupit. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i SPB Shkup, me autorizim të prokurorit publik. Fillimisht, arsye për aksidentin është shpejtësia e papërshtatshme, ndërsa dëmi i përgjithshëm vlerësohet në mbi 300 mijë denarë.

Vdes punëtori që ra nga skela

Shkup, 29 shtator - Një punëtor 38 vjeçar nga fshati i Strugës Oktisi, dje e ka humbur jetën pasi kishte rënë nga skela gjatë kryerjes së punëve ndërtimore. MPB-ja kumtoi se dje në orën 16:45 në Gjevgjeli gjatë kryerjes së punëve ndërtimore të një shtëpie pronë e A.D. nga skela ka rënë S.U. (38) nga fshati Oktisi-Strugës, i cili ishte angazhuar përmes firmës "Mansard" nga Gjevgjelia. Nga lëndimet e marra, gjatë rrugës për në Shtëpinë shëndetësore Gjevgjeli, S.U. e ka humbur jetën. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi nga Stacioni policor Gjevgjeli dhe inspektori shtetëror për punë. Me urdhër të Prokurorit publik ndaj trupit të të ndjerit do të kryhet autopsi.

Takim rajonal për emigrantët në Maqedoni dhe Serbi

Shkup, 29 shtator - Dhjetë rrjete lokale nga Maqedonia dhe Serbia, për mbështetjen e politikave dhe shërbimeve të emigrantëve mbajtën takim rajonal në Beograd. Përfaqësuesit e këtyre rrjeteve diskutuan për nevojën e monitorimit të politikave dhe shërbimeve në nivel lokal. Në Maqedoni hyjnë Shkupi, Kumanova dhe Gjevgjelia, ndërsa në Serbi Presheva, Vranja, Beogradi, Shid, Subotica dhe Mitrovica e Sremit. Anëtarë të rrjeteve janë përfaqësues të institucioneve, qendra për punë sociale, qendra arsimore, agjencitë për punësim dhe shoqatat e qytetarëve. "Në Maqedoni dhe Serbi është e rëndësishme të kuptojmë se institucionet midis tyre është e nevojshme të bashkëpunojë pasi që ekziston një numër i vogël i person-

ave të cilët kanë kërkuar azil, ndërsa të njëjtëve duhet që rregullativat juridike t'u mundësohen që të kemi integrim cilësor të tyre. Ne në takim u dakorduam se do ta ndjekim gjendjen në nivel lokal dhe do të jemi korrigjues të institucioneve që të përmirësohet politika për bashkëjetesë në qytete", thonë nga Shoqata e juristëve të Republikës së Maqedonisë. Në kumesë theksohet se në Serbi ka 3.500 emigrantë, ndërsa në Maqedoni janë rreth 40 emigrantë, të sistemuar në komunat Shkup, Kumanovë dhe Gjevgjeli. Në vijim është duke u zbatuar hulumtim për gjendjen e emigrantëve në Maqedoni dhe Serbi, duke u fokusuar në veçanti tek gratë dhe fëmijët emigrantë, i cili do të prezantohet deri në fund të vitit.

MINISTRIA E EKONOMISË

Ministria e ekonomisë, në pajtim me Programin për mbështetje të turizmit vendor për punëtorët me të ardhura të ulëta në Republikën e Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 120 të datës 01.09.2017), publikon:

VAZHDIM TË AFATIT TË THIRRJES PUBLIKE
Për organizim të pushimit për punëtorët me të ardhura të ulëta

- Në pajtim me Programin për mbështetje të turizmit vendor për punëtorët me të ardhura të ulëta në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 120 të datës 01.09.2017), Ministria e ekonomisë ka publikuar Thirrje publike për organizim të pushimit për punëtorët me të ardhura të ulëta.
 - Qëllimi themelor i këtyre projekteve është që të ju mundësohet personave me të ardhura të ulëta të shfrytëzojnë pushim vjetor, dhe në të njëjtën kohë të ju ndihmohet qendrave turistike në rritjen e kapacitetit të punës jashtë sezonit turistik.
 - Ministria e ekonomisë do të japë Vërtetim për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar për punëtorët me të ardhura të ulëta, në shumë të përgjithshme me vlerë prej **15.000 denarë** dhe e njëjta të përdoret në një prej objekteve të kategorizuara hotelerike për akomodim në Republikën e Maqedonisë që do të paraqiten në Ministrinë e ekonomisë.
- Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike** kanë të gjitha subjektet fizike të cilët janë të punësuar dhe të ardhurat e tyre në familje nuk kalojnë në neto të ardhurat në shumë prej **22.000,00 denarë**.
 - Një person mund të parashtrorë vetëm një kërkesë për shfaqje të interesimit për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar.
 - Për pjesëmarrje sipas Thirrjes publike punëtorët me të ardhura të ulëta – kërkesat deri te Ministria e ekonomisë duhet të parashtrorë:
 - Formular të plotësuar të kërkesës (formular të gatshëm);
 - Vërtetim nga punëdhënësi për shumën e neto pagës së paguar për tre muajt e fundit dhe certifikatë nga banka për tre muajt e fundit për parashtruesin e kërkesës si dhe të anëtarëve të familjes (bashkëshortit, bashkëshortes dhe fëmijëve) të cilët së bashku me atë do të shfrytëzojnë pushimin;
 - Fotokopje të letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtimit për atë dhe anëtarët e familjes të cilët së bashku do të shfrytëzojnë pushimin dhe
 - Deklaratë se kërkesi personalisht ose me anëtarët e familjes që janë theksuar në kërkesë do të shfrytëzojnë pushimin (formular i gatshëm).
- Të drejtë për marrje të Vërtetimit për pushim** kanë të gjitha subjektet fizike të cilët janë të punësuar dhe të ardhurat e tyre mujore në familje nuk kalojnë neto të ardhurat në shumë prej **22.000,00 denarë**.
 - Formulari i kërkesës për shfaqje të interesimit për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar mund të merret në arkivin e Ministrisë së ekonomisë ose të sigurojë përmes internet faqes të ministrisë: www.economy.gov.mk
 - Kërkesa mund të parashtrorë deri në arkivin e Ministrisë së ekonomisë personalisht ose përmes postës në adresën (Jurij Gagarin nr. 15 Shkup)
 - Për çdo Vërtetim, Ministria e ekonomisë do të mbajë evidencë për personat të cilët shfrytëzojnë dhe në cilin objekt hotelerik për akomodim të përdoret.
 - Kërkesat për marrje të Vërtetimit do t'i shqyrtojë Komisioni i formuar nga ana e Ministrisë së ekonomisë.
 - Komisioni pas arritjes së të gjitha kërkesave për pushim të organizuar të parashtruara gjatë kohëzgjatjes së Shpalljes publike, me procesverbal do të përcaktojë numrin e saktë të kërkesave të arritura dhe do të përpilojë Listë për kërkesit që kanë dokumentacion të rregullt dhe të kompletuar që së bashku me raportin e parashtrorë deri në Ministrinë e ekonomisë.
 - Punëtorët me të ardhurat e ulëta – kërkesit që nuk kanë parashtruar dokumentacion të rregulluar dhe të kompletuar nuk do të evidentohen në Listën e kërkesëve.
 - Lista e kërkesëve që kanë parashtruar dokumentacion të rregulluar dhe të kompletuar publikohet në ueb faqen e Ministrisë së ekonomisë më së voni shtatë ditë nga dita e përcaktimit të listës.
 - Punëtorëve me të ardhura të ulëta – kërkesve që janë të evidentuar në Listën e kërkesëve, Ministria e ekonomisë u jep Vërtetim për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar në shumë prej **15.000,00 denarë**.
 - Vërtetim për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar jepet sipas parimit "i pari i paraqitur, i pari i shërbyer".
 - Vërtetimi për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar mund të shfrytëzohet vetëm nga punëtori, të cilit i jepet së bashku me anëtarët e tij të familjes (bashkëshorti, bashkëshortja dhe fëmijët), të cilët janë të theksuar në kërkesë.
 - Pushimi do të organizohet në objektet hotelerike për akomodim në qendrat turistike të Republikës së Maqedonisë, jashtë vendbanimit të personit – parashtruesit të kërkesës, në periudhë jo më shumë se pesë ditë.
 - Mbikëqyrjen mbi realizimin e Projektit do ta realizojë Komisioni i formuar nga Ministria e ekonomisë.
 - Thirrja publike është e publikuar në ueb faqen e ministrisë së ekonomisë www.economy.gov.mk.
 - Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kompletuar parashtrorë në Arkivin e Ministrisë së ekonomisë, rr. "Jurij Gagarin" nr. 15, Shkup deri më **31.10.2017**.

Për informata më të hollësishme drejtohuni në:
tel: (02) 3093 536; (02) 3093 539; (02) 3093 543 · faks: (02) 3093 540: e-mail: toursim@economy.gov.mk



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alineja 9 e Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/07, 5/09 dhe 43/2014), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural në vijim publikon

THIRRJE PUBLIKE Nr. 01/2017

Për parashtrimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në Peshkatari dhe Akuakulturë për vitin 2017

I. LËNDË E THIRRJES PUBLIKE

Lëndë e kësaj thirrje publike është ndarja e përkrahjes për nënpikat nga masat në vijim:

Masa 2	Përkrahja financiare në akuakulturë	Mjetet	Vlera maksimale të shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 2.1	Përkrahje financiare për investime në akuakulturë - Ndërtim të kapaciteteve të reja për akuakulturë - Zgjerim, rikonstruim, adoptim dhe modernizim të kapaciteteve ekzistuese për akuakulturë - Ndërtim të kapaciteteve të reja për përpunimin e peshqve - Furnizim të pajisjeve për punim fillestar, përpunim, deponim dhe paketim të peshqve	10.000.000,00 denarë	7.000.000,00 denarë për shfrytëzues individual

II. SHFRYTËZUES

Të drejtë për shfrytëzim të mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për nënpikat:

Subjekt	Nënpika
Shfrytëzues të mjeteve dedikuar për ndërtim të kapaciteteve të reja për akuakulturë janë: Subjektet të cilat janë të regjistruara për veprimtari akuakulturë dhe të cilët posedojnë ose shfrytëzojnë pronë të patundshme në të cilën planifikojnë të ndërtojnë kapacitet për akuakulturë; ose posedojnë leje për shfrytëzim të ujit për vendosje të kafazeve në zonat e parapara për akuakulturë	2.1
Shfrytëzues të mjeteve dedikuar për zgjerim, rikonstruim, adoptim dhe modernizim të kapaciteteve ekzistuese për akuakulturë janë: Subjektet të cilat janë të regjistruar për veprimtari akuakulturë, dhe janë të regjistruara në regjistrin e ruajtësve të peshqve që mbahet në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave;	2.1
Shfrytëzues të mjeteve dedikuar për ndërtim të kapaciteteve të reja për përpunim të peshqve janë: Subjektet të cilat janë në rangun e ndërmarrjeve mikro, të vogla ose të mesme të regjistruara për veprimtari akuakulturë dhe posedojnë ose shfrytëzojnë pronë të patundshme në të cilën planifikojnë të ndërtojnë kapacitet përpunues;	2.1
Shfrytëzues të mjeteve dedikuar për furnizim të pajisjeve për përpunim fillestar, përpunim, deponim dhe paketim të peshqve janë subjekte të cilat janë në rangun e ndërmarrjeve mikro, të vogla ose të mesme të cilat posedojnë ose shfrytëzojnë objekt i dedikuar për përpunim të peshqve.	2.1

III. SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE

Mjetet janë dedikuar për investime për furnizim të mjeteve fillestare, shpenzime operative që kanë të bëjnë me mjetet e furnizuara dhe shpenzime të tjera të parapara me Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2017 (Gazeta Zyrtare nr. 192/2016).

Për Masën 2.1, përkrahja financiare paguhet sipas parimit të bashkëfinancimit të investimeve përfundimtare dhe të paguara nga ana e shfrytëzuesit në shumë të 50% nga vlera shpenzimeve të lejuara/pranuara për investime. Shkalla e bashkëfinancimit rritet deri në 55%, 60% dhe 65% në rastet kur:
- 55% nga vlera e investimit të lejuar për investime të parashtruara nga bartës të ekonomisë bujqësore prej moshës 18 vjeçare deri në moshën 40 vjeçare në ditën e parashtrimit ose grua bartëse e ekonomisë bujqësore;
- 60% nga vlera e investimit të lejuar, për investime në ekonominë bujqësore që gjendet në rajonin rural kodrinor-malor;
- 65% nga vlera e investimit të lejuar, për investime të parashtruara nga bartës të ekonomisë bujqësore prej moshës 18 vjeçare deri në moshën 40 vjeçare në ditën e parashtrimit ose grua bartëse e ekonomisë bujqësore që gjendet në rajonin rural kodrinor-malor.
Përkrahja e ndarë financiare është e paktyshme.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË PARASHTRORËT

Kërkesat për çdo nënpikë veç e veç parashtrorë në origjinal.
Kushtet të cilat duhet t'i parashtrorë kërkesit e mjeteve përcaktohen në Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2017 (Gazeta zyrtare nr. 192/2016).
Nëse në Agjenci parashtrorë më shumë kërkesa sesa ka mjete në dispozicion në pajtim me Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2017, Agjencia do tu japë përparësi atyre kërkesëve që kanë parashtruar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.
Kërkesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëfinancim me Agjencinë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

V. MARRJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve" (Formular PRA – A1) me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimi për shfrytëzuesit mund të merren në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk
Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjenci në adresë çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30:
Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Bul. "Brigada e 3-të Maqedonase" nr. 20 (Ndërtesa e Makedonija Tabak Bloku C) 1000, Shkup

VI. MËNYRA E PARASHTRIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuar për përkrahje financiare dhe pagesë të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2017 së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm parashtrorë në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur në të cilin në pjesën e parme në këndin e epërm të majtë qëndron mbishkrimi "MOS HAP", për Thirrje publike numër 01/2017 shënim të shifrës së nënpikës për të cilën parashtrorë kërkesa. Kërkesa mund të parashtrorë përmes postës ose personalisht në sportelin e Agjencisë në të kundërtën Agjencia nuk ndërmerr përgjegjësi për arritje jo në kohë dhe e pakompletuar të dokumenteve në sportel ose për hapje të parakohshme të kërkesës.

Afati përfundimtar për parashtrimin e kërkesave është deri më 16.10.2017.

Kërkesat e parashtruara pas afatit përfundimtar nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.
Informacione më të detajuara në kontakt telefonin (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për miratim të projekteve dhe Sektori për miratim të pagesës.
Telefoni: 02/3097-460, çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 16.30.
E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk



Nga Komuna e Tetovës janë arsyetuar se shtrati i Lumit Shkumbin pastrohet rregullisht, por mbeturinat përfundojnë në lum si pasojë e disa banorëve të pandërgjegjshëm. Në ndërkohë, nga komuna kanë theksuar se kanë përgatitur një plan akcional, i cili i është dorëzuar qeverisë gjatë kohës së vërshimeve

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 29 shtator - Ditët e para të vjeshtës, të cilët u karakterizuan me reshje të shiut në Tetovë dhe rrethinë kanë gjetur Lumit Shkumbin të papastruar. Së këndejmi, Lumi Shkumbin në Tetovë vazhdon të jetë përplot me gurë dhe i papastruar gjatë rrjedhës së tij brenda në qytet. I njëjti është përplot me rërë dhe gurë që vijnë nga pjesët më të larta dhe të njëjtat nuk janë larguar, gjegjësisht autoritetet lokale nuk kanë ndërmarrë masa për pastrimin e të njëjtit. Banorët janë shprehur të revoltuar dhe thonë se lumi duhet të pastrohet rregullisht. Ata sqarojnë se një pasqyrë e këtyllë në Lumit e Tetovës zgjatë një kohë të gjatë dhe kërkojnë që të pastrohet, sepse në të kundërtën kjo mund të ketë pasojat gjatë periudhës që vijon.

"Një kohë të gjatë Lumi Shkumbin është në këtë gjendje i papastruar. Është përplot me gurë të mëdhenj dhe me rërë. Fatmirësisht nuk ka pasur shumë reshje të shiut, sepse do të vërshonte

Kërkohet pastrimi i lumit të Tetovës

Vjeshta e gjen të papastruar Shkumbinin



sërisht në shtëpitë tona si një vit më parë. Duhet që të pastrohet rregullisht, sepse pak shi kur bie lumi sjellë nga pjesët më të larta gjithçka që gjen përpara, gurë, dheun që shkëputet, mbeturina të ndryshme të amvisërisë që hidhen në lum të cilët nuk hidhen në kontejner", thotë Agroni, banorë i Tetovës. Banorët janë ankuar se autoritetet lokale duhet që të marrin masa parandaluese në kohë, sepse tashmë në muajt në vijim pritet që të rritet niveli i ujit të Lumit Shkumbin dhe rreziku për të vërshuar i njëjti është i madh.

"Tashmë kur jemi në vjeshtë rritet niveli i ujit të Lumit Shkumbin, prandaj edhe ne druajmë se nëse nuk pastrohet në kohë, atëherë mund të vërshojë në shtëpitë tona. Duhet që përfundimisht ky problem të rregullohet njëherë e mirë, sepse nuk është hera e parë që është në këtë gjendje lumi", thotë më tej ai.

Banorë të kësaj lagje thonë se lumi pastrohet pjesërisht. "Ajo pjesë e lumit është pastruar dy herë në mënyrë sipërfaqësore, por fatkeqësia qëndron aty se edhe sot e kësaj ditë vazhdo-

het që të hidhen mbeturina, me çka e ngushton edhe shtratin e lumit. Apelojmë te Komuna që ajo pjesë e shtratit të lumit të pastrohet në vazhdimësi dhe mundësisht ajo pjesë të futet në shtrat", shprehen banorët. Nga Komuna e Tetovës janë arsyetuar se shtrati i Lumit Shkumbin pastrohet rregullisht, por mbeturinat përfundojnë në lum si pasojë e disa banorëve të pandërgjegjshëm. Në ndërkohë, nga Komuna e Tetovës, kanë theksuar se kanë përgatitur një plan akcional, i cili i është dorëzuar Qeverisë gjatë kohës së vërshimeve. "Në atë plan është dorëzuar edhe kërkesa për naftë për pastrim të Lumit Shkumbin. Ministria e Ekologjisë ka ndarë 8 tonë për pastrimin e Lumit Shkumbin, Poroj dhe në Reçicë", thonë nga Komuna e Tetovës. Shtrati i lumit në Tetovë, vazhdon të jetë "kontejner" mbeturinash, dhe në të jo rrallë mund të shihni aparaturë kuzhine, mobile, kafshë të ngordhura dhe pemë të prera, gjë që vjen nga mungesa e kontrolleve të vazhdueshme të inspektoratit të ekologjisë.

Grupi "Larondina" nga Londra në Shkup



Fëmijë me aftësi të kufizuara zbulojnë talentet artistike

Shkup, 29 shtator - Nga data 5 tetor e deri më 10 tetor, në Maqedoni do të qëndrojë grupi i valltarëve "Larondina" nga Londra, i përbërë nga persona me aftësi të kufizuara, të cilët në Manastir dhe Shkup do të performojnë disa valle artistike në Teatrin kombëtar në Manastir me datë 6 tetor (e premtë) me fillim në ora 18 dhe me datë 7 tetor (e shtunë) në Shkup në hapësirat e TV21, pra 18.00. Grupi i valltarëve "Larondina" nga Londra vjen në Shkup nën patronatin e Veronika Gare, bashkëshortja e ambasadorit të Britanisë së Mashë në Shkup, mbështetur nga UNICEF Maqedoni. Sipas Veronika Gare, bëhet fjalë për grup valltarësh nga Londra, fëmijë me aftësi të kufizuara, të trajnuara përmes metodave të nga drejtori artistik i shkollës, Angelina Alessandre, e cila përdor programin e saj imagjines si një bazë solide. Ajo krijon valle me muzikë e cila i tërheq dhe i motivon, me disiplinë, durim dhe një ndjeshmëri të plotë dhe mirëmban vëmendjen tek nxënësit ata dëgjojnë, kujtojnë dhe gradualisht lidhin një lëvizje me njërin - tjetrin për të fituar mjeshhtërinë përfundimtare të vallëzimit. "Kjo shkollë përmirëson aftësitë e tyre për lëvizje dhe zhvillimin e tyre intelektual", tha Gare. Ajo njëherit bëri apel deri te prindërit që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, t'i marrin fëmijët e tyre dhe të shikojnë dy performancat në Manastir dhe Shkup, se si këta fëmijë vallëzojnë sikur të jeni profesionistë. Hyrja në të dyja shfaqjet si në Manastir dhe në Shkup janë falas. (Z.V.)

Promovohet libri më i ri i Dautogllut

Qyteti do t'ju mësojë shumëçka

Shkup, 29 shtator - Shtëpia botuese "Logos -A" të enjten ka promovuar librin më të ri të ish kryeministrit të Republikës së Turqisë, Ahmet Dautogllu me titull "Qytetërimi dhe qytetet". Në këtë eveniment, në të cilin ishte prezent edhe vet autori Dautogllu, ideatori i shtëpisë botuese Logos A, Ismail Bardhi, ndër të tjera tha se "në krye të qytetërimit qëndron njeriu, si krijesa më e lartë që i është paraqitur gjithësisht. Qytetërimi, zbulurimi më të madh ia jep njeriu. Njeriu mundohet t'ia mundësojë lirinë, sigurinë, qetësinë, barazinë, frymëmarrjen".



Nga ana tjetër, zoti Ahmet Dautogllu tha se ndjen një kënaqësi të veçantë që është në Shkup, duke e cilësuar këtë qytet si vendlindje të tij. Kënaqësia është e veçantë,

theksoi Dautogllu, që shkak i vizitës është libri, respektivisht debati rreth librit.

"Kam vizituar shumë qytete anekënd botës dhe nga çdo qytet kam mësuar diçka.

Nëse e lexoni një libër, apo nëse e dëgjoni një profesor, nuk do të mësoni gjërat pjesërisht. Por nëse e ndjeni një qytet, ai do t'ju mësojë gjithçka. Çdo qytet, është një orë e ndalur e historisë dhe një klasë, nga çdo gur mëson diçka". Profesori Dautogllu tha se edhe shkupjanët duhet të marrin mësimet që i jep Shkupi. Ai tha se në qendër të Shkupit dikur ka ekzistuar xhamia Burmal, ndërsa në afërsi të sajë ka pasur edhe një kishë dhe sinagogë. Kësisoj, ish kryeministri turk tha se shkupjanët kanë shumë për të mësuar nga fryma e qytetit të tyre".

Ndahen shpërblimet për storje më të mirë sociale

Shkup, 29 shtator - Këshilli për etikë në mediat të premtën ka shpallur shpërblimet nga konkursi për storje më të mirë gazetareske nga fusha e jetës socialo-shoqërore, me fokus në avancimin e të drejtave të njeriut dhe promovimit të drejtave të grupeve sociale të pa mbrojtura dhe grupet e marginalizuara. Sipas vendimit të njëzëshëm të Komisionit treanëtarësh, vendin e parë e ka fituar storja nga gazetarja Irena Mullaçka nga Fokus, për skandalin në Gjinekologjinë në Shku,



ose pas vdekjes së 80 foshnjave të sapolindura. Storja e cila zuri vendin e dytë të konkursit të sivjetshëm të KEMM është ajo e

gazetarit Nikola Zdravkoviç, për storen me titull "Tragjedi familjare e la pa copë buke Gordana Slavkoviç", e publikuar në

emisionin 360 shkallë, në televizionin Alsat-M. në ndërkohë, vendin e tretë e kanë ndarë dy produkte gazetareske, e para i takon gazetares Mirjana Mirçevska-Jovanoviç për serialin storje për "Ivani i vogël dhe gjyshja e tij", e transmetuar në televizionin Kanal 5, si dhe storja e gazetari Marjan Nikolovski për raportin "A munden bashkësitë fetare ti heqin të gjitha barrierat për lutje të pa ndërprerë", e transmetuar në televizionin Sitel, në emisionin "Në anë të njëjtë". Përveç shpërblimeve për storje më të

mirë, Komisioni ka vendosur të jep edhe dy falënderime. Në rastin e parë për storjen gazetareske të autores Maja Ravanska për tekstin me titull "Stiv Hoking-u maqedonas i ngul-fatur në unazat e shoqërisë jo inkluzive", e shpallur në gazetën "Fytyrë përballë fytërës", si dhe për storjen televizive "Të shikojnë ata që duhet të shikojnë" e autorit Zoran Jovanovski, nga projekti 360 shkallë të Alsat-M televizionit. "Shpërblimet e sotshme janë dëshmi për profesionalizmin e autorëve. Shumë shpesh e kemi cekur

rëndësinë e gazetarisë profesionale, për rolin e mediate në publikimin e informative objektive, për nevojën e përmirësimit të kushteve të punës të gazetarëve si dhe për vetë-rregullimin në kalimin e sfidave etike. Të gjitha këto pyetje janë aktuale sot e kësaj dite", tha ambasadori i BE-së, Samuel Zhbogar në fjalimin e tij. Shpërblimet këtë vit janë siguruar me përkrahje financiare nga UNESKO dhe BE si pjesë e projektit "Ndërtim të besimit në mediat në Evropën Juglindore dhe Turqinë".



Në fillim të viteve 70-të, të shekullit të XIX, Ymer Prizrenin e shohim të propagandojë kundër Portës së Lartë e cila duke mos pasur fuqi të ndeshet me forcat madhore evropiane dhe të nënshtrorë me çdo mjet kombin shqiptar

Anisa DEMIRAJ

Një nga njerëzit që historia e mban në piedestalin e saj është edhe ai, i madhi Ymer Haxhi Prizreni, atdhetari dhe kryetari i Lidhjes së Prizrenit. Ymer Haxhi Prizreni lindi dhe u rrit në fshatin Nashec të Bregut të Drinit dhe përkon me një varg masash që Porta e Lartë kish ndërmarrë në Shqipëri, në rrafsh të shtypjes së kryengritjeve shqiptare që kundërsh-tonin reformat e Tanzimatit. Ymer Prizreni, tashmë i shkolluar dhe i edukuar në frymën fetare të kohës, predikon paqe mes bashkëkombasve të tij. Ai ndërhyt energjikisht, disa herë tek autoritetet vendore turke, me ç'rast këto të mos kërkonin taksa ngase varfëria e shqiptarëve po arrinte kulmin. Por thirrjet e sinqerta të Ymer Prizrenit, binin në veshin e shurdhër të tagrambledhësve turq. Këtë do të buronte ai zhgënjim shpirtëror i shqiptarit Ymer Prizreni ndaj Portës së Lartë. Tashmë për të ishte e qartë se kullat fetare në Stambollin e gjatë, në mbarë Turqinë, predikonin nënshtrimin deri në baltë të identitetit kombëtar, përpara interesave madhore të Perandorisë Osmane. Me këtë akt përuljeje, nuk mund të pajtohej kurrsesi Prizreni, i cili u rrit sa me dashurinë dhe edukatën e lartë prindërore, aq edhe me legjendat trimërore të Bregut të Drinit, ku valët e këtij lumi, janë padyshim simfonia epike e maleve shqiptare. Më pas, Ymer Efendiun e shohim të shpërngulet në qytetin e Prizrenit, në kujdesie të familjes së vet e cila fal provave, gëzonte një popullaritet të madh në ato vite. Megjithatë zotëron katër gjuhë, ka kulturë të përgjithshme të mjaftueshme, ai nuk mund të ulet as në ndonjë zyre të Portës së Lartë në Prizren, ngase disa herë, haptaz i është kundërvënë, vendimeve të ardhura nga Stambolli. Sigurisht në vitet 70-të të shekullit të XIX, atëherë kur Porta e Lartë u gjend përballë të papriturave të mëdha, edhe fakti i Shqipërisë rrezikohej së tepërmi.

Rreth besës së madhe

Në fillim të viteve 70-të, të shekullit të XIX, Ymer Prizrenin e shohim të propagandojë kundër Portës së Lartë e cila duke mos pasur fuqi të ndeshet me forcat madhore evropi-

Ata që e bënë historinë

Ymer Haxhi Prizreni, kryetari i parë i Shqipërisë së Katër Vilajeteve



ane dhe të nënshtrorë me çdo mjet kombin shqiptar. Një forcë e re e madhe do të përpiquej me çdo kusht që të formohej një shtet i madh sllav në Ballkan dhe kjo ishte Rusia që kërkonte me çdo kusht pushtimin dhe nënshtrimin e Kosovës. Rusia kurrsesi nuk mund të shihte me sy të mirë bashkimin e vilajeteve shqiptare nën një administratë të vetme ç'ka donte të thoshte formimin e njësisë kombëtare me tendencë të pavarësisë. Për këtë, konsulli rus në Cetinjë i shkruante Ministrin të Punëve të Jashtme të Ru-

sisë, Giersit se: "Shqiptarët nuk egzistojnë si racë si kombësi e veçantë, por formojnë vetëm një numër fisesh pa kohezion të mbrendshëm". (Arkivi i Institutit të Historisë, sipas dokumenteve të Vjenës, dokumenti 18, 3 prill 1878). Kështu, patriotët shqiptarë, të gjendur mes vrundujve të stuhive që donin të gëlltinnin tokat shqiptare, u mblodhën rreth besës së madhe që i patën dhënë atdheut. Kjo Lidhje ishte një imperativ, një klithmë shprese që toka arbërore të ringritej pas pesë shekujsh robërie duke

ndriçuar sërish virtutet e shenjta morale të saj. Në këtë rizgjim të vetëdijes sonë kombëtare, vepra e Ymer Prizrenit është e pazëvendësueshme. Kjo vepër madhore ka rezervuar në dekadat që erdhën më pas me një tingëllim të çuditshëm. Ajo ka mbetur ende sot e skalitur në memorien e kombit tonë. Në pranverën e vitit 1878, menjëherë pas themelimit të "Komitetit Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare" Ymer Prizreni merr kontakte me udhëheqës të këtij komiteti siç ishin Zija Prishtina dhe

Abdyl Frashëri.

Idetë dhe vendimet e këtij komiteti, biri i Prizrenit, përpiquej t'i përcjellë tashmë në krejt viset e Kosovës, duke parë se ky komitet, i themeluar në Stambollin, menjëherë do të shpërngulej për në Shqipëri, Ymer Prizreni merr takime të fshehta edhe me kapedanët e shquar të asaj kohe në viset veriore shqiptare siç ishin Ali Ibra, Sef Kosharja, Ramadan Zaskoci e Sulejman Vokshi. Ngase u njihje rëndësinë e propagandës, Ymer Prizreni, u vu në qendër të asaj lëvizjeje madhore të shqiptarëve të cilët, me anë të protestave dërguar fuqive të mëdha, i bënë të qartë opinionit evropian se ata jo vetëm që nuk do ta njohin copëtimin e vilajeteve shqiptare, por do të mbrojnë me çdo çmim atë. Në pothuaj të gjitha protestat e popullit të Prizrenit në ato kohë, në krye të emrave gjendet emri i Haxhi Ymer Efendiut. Për më tej, në maj të vitit 1878, në një protestë dërguar sulltanit në emër të qytetit të Prizrenit, përveç të tjerave, Haxhi Ymer Efendiun shprehej se "kërkonte respektimin e tërësisë së tokave shqiptare, bashkimin e tyre në një provincë të vetme dhe zbatimin e reformave për përparimin e vendit" (Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, doku.9, faqe. 20). Në tubimin e 10 qershorit të Lidhjes shqiptare, Haxhi Ymer Efendiun, mori pjesë në cilësinë e delegatit të Prizrenit. Ngase aktiviteti i

tij ishte paraparë si tejet i madh në këtë rrafsh, me shumicë votash, Ymer Prizreni zgjidhet këtu anëtar i Këshillit Qendror të Lidhjes Shqiptare. Fjala e matur e tij, mendimi i urtë dhe trimëror, ishin vendimtare në idetë e shprehura, në këtë kuvend madhor të shqiptarëve. Është me vend të kujtojmë, se në tubimin e parë të atdhetarëve që nënshkruan Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, u vendos që kjo Lidhje do mosdoshmërisht do të mbronte tërësinë tokësore shqiptare. Ajo nuk do të njihje askurrë qeverinë bullgare e dalë prej Traktatit të Shën Stefanit ku mijëra kilometra katrorë toke shqiptare i dhuroheshin asaj. Por me shtrimin e disa ideve të Ymer Prizrenit, Lidhja mori vendim që nëse dikush nga radhët e saj nuk do t'i kryejë me përgjegjësi e ndërgjegje detyrat, nëse ai shpërdoron emrin e kësaj Lidhjeje për të kryer akte antinjeroze, ai do të dënohet sipas fajit dhe do t'i sekuestrohet krejt pasuria. Biri i Prizrenit, u ndal në fjalën e tij edhe në bashkëjetesën vëllezërore që shqiptarët myslimanë duhet të kenë me ortodoksët apo katolikët. Religonet fetare do të ishin ura të shenjta bashkimi dhe jo fole hasmërishe. Menjëherë pas mbarimit të këtij tubimi, Haxhi Ymer Efendiun u vu punës për të përballuar detyrat e mëdha të ngarkuara. Në shoqërinë e Shuaip Spahiu, Sulejman Vokshit, Ibrës dhe Berishës, biri i Prizrenit diti të organizojë më së miri formacionet e para luftarake shqiptare duke i angazhuar ata në detyra konkrete. Por ngase Prizreni me rrethinë, paraqiste mjaft probleme edhe për organizimin e pushtetit vendor, ai brenda muajve qershor-korrik 1878, shkoi kullë më kullë prizrenase duke qarë hallet e duke gjetur zgjidhje sa më të përshtatshme për bashkëkombasit e vet.

Tre ore debat

Veçmas organizimi i tij në protestat ndaj padrejtësive që iu bënë Shqipërisë në Kongresin e Berlinit, do të ishte i madh. "Ymer Prizreni ishte i ngarkuar me detyra të rëndësishme në këshillin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit... Kështu gjatë periudhës kur vazhdonin punimet e kongresit të Berlinit dhe pas tij, Ymer Prizreni mori pjesë në organizimin dhe udhëheqjen e të gjitha aktiviteteve politike dhe ak-




www.sa-kra.ch



sioneve që u zhvilluan nga masat popullore kundër zbatimit të vendimeve të këtij kongresi dhe përpjekjeve të qeverisë osmane për realizimin e tyre. Ai zhvilloi një aktivitet intensiv për organizimin e rezistencës së masave popullore, kundër misionit të Mehmet Ali Pashë Maxharit” (Instituti i Historisë Tiranë, konferenca e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, faqe 71).

Në fundgushtin e vitit 1878, krejt forcat ushtarake të Lidhjes Shqiptare, ishin mobilizuar për mbrojtjen e trojeve të tyre të Plavës dhe Gucisë. Ndërkaq Knjaz Nikolla kishte pasur disa bisedime të fshehta me Portën e Lartë, lidhur me këto përgatitje dhe kundërshtime të shqiptarëve. Është kjo arsyeja që nga Stambolli shkoi në Prizren më 25 gusht, një autoritet i lartë i Portës, me ç’rast kërkon të bisedojë me udhëheqësit e lartë të Lidhjes. Më 26 gusht 1878, në ndërtesën e vogël të komitetit Qendror të kësaj Lidhjeje Ymer Prizreni bëri mbi tre orë debat me të ardhurin nga Stambolli, me ç’rast i shpjegoi se ishte Mali i Zi që duhet të hiqte dorë nga trojet shqiptare autoktone dhe jo shqiptarët të ulnin armët përballë kësaj padrejtësie që i bënte Fuqitë e Mëdha. Në vitet 1879-1880, me porosi të vetë Abdyl Frashërit, Ymer Prizreni u ngarkua të mobilizojë dhe organizojë masat e gjëra popullore, në zbatim të ideve ushtarake të Lidhjes Shqiptare. Këtë detyrë kaq të vështirë për moshën e tij ai e kreu me energji thuajse djaloshare.

Kudo ku shkeli këmba e tij, në Prizren, Gjilan, Lumë, Manastir, Tetovë, Gostivar etj, dyert e kullave u çelën. Këto kulla dhanë për luftën, për trojet e Plavës e Gucisë jo vetëm të holla, ushqime dhe armë, por edhe qindra e mijëra djem të njomë në mbrojtje të atdheut të tyre. Ymer Prizreni hasi në plot pengesa që i ngritën shqiptarët të gënjyer e mashtruar nga Porta e Lartë. Gjykimi i tij do të përballej me nënpunësit turq të administratës të cilët në pamundësi për të vjedhur e mashtruar popullin, detyroheshin të merrnin vetë rrugën drejt Stambollit. Aq të pafuqishëm e ndjenin veten e tyre këta administratorët, sa që në një raport të konsullit austro-hungarez në Prizren, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vienë, thuhet veç të tjerave tekstualisht: “Po shtohet çdo ditë e më shumë veprimtaria dhe prepotenca e qeverisë faktike që është e dalë prej Lidhjes. Kjo prepotencë po rritet dukshëm dhe kryetari i Lidhjes së këntushme, Ymer Prizreni, po e zbaton këtë terror kundër administratës turke, në bashkëpunim me nënpresidentin dhe oratorin e komitetit Shuaip Agën”. (Arkivi i Institutit të Historisë-Tiranë, sipas dokumentave të Vjenës,



Pikturoi: Bajram Gërdellaj

dokumenti nr.53 datë 23 qershor 1880). Po sipas burimeve arkivore të Vienës, është pikërisht konsulli austro-hungarez i cili njofton Ministrinë e Jashtme në Vienë se lidhur me vendimet e fundit të Berlinit “Haxhi Ymer Efendiu nuk nguroi t’i dërgonte në rrugë telegrafike, në emër të të gjithë shqiptarëve, një protestë kërcënuese konferencës së Ambasadorëve në Berlin”.



Punët e Shqipërisë mund t’i zgjidhin veçse shqiptarët

E vërteta është se në vjeshtën e vitit 1880, Lidhja Shqiptarë, pati shtrirë pushtetin e saj administrativ, ushtarak dhe politik në mjaft krahina siç ishin ato të Prizrenit, Gjakovës, Vuçitërnit, Preshevës, Pejës, Plavës, Gucisë, Manastirit, Tetovës, Dibrës, Korçës e deri në Janinë. Ky pushtet, u kujdes së pari për mbrojtjen

e kufijve të vilajeteve shqiptare e mandej për rregullimin e jetës në vend. Njëherazi, kjo shtrirje gjeografike e Lidhjes, nxori në pah domosdoshmërinë e një organizimi të ri. Kësisoj në dhjetorin e vitit 1880, burrat e shquar të kësaj Lidhjeje u mbledhën sërisht në Prizren. Aty u soll krejt çka Lidhja Shqiptare kish humbur e kish fituar në gati tri vjetët e egzistencës së saj dhe natyrisht debatet kanë qenë të mëdha. Grupi konservator i këtij organizimi, bëri çmos të lidhte synimet dhe idetë e Prizrenit, pas qerres së Portës së Lartë. Por ata u ndeshën në qëndrimin e burrave të tillë si Iljaz Pashë Dibra, Shuaip Spahiu, Abdyl Frashëri, Jakup Ferri dhe Ymer Prizreni të cilët kumtuuan në çdo rast se punët e Shqipërisë mund t’i zgjidhnin veçse shqiptarët. Në organizimin e ri të Lid-

hjes, u vendos që ajo të merrte përsipër atributet e një qeverie të përkohshme dhe unanimisht patriotët e mbledhur aty zgjodhën në krye të kësaj qeverie Ymer Prizrenin.

Është me vend të theksohet se prej kësaj dite e deri atëherë kur Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shtyp me zjarr e hekur, personaliteti i Ymer Prizrenit u shfaq dukshëm në krejt dimensionin e vet atdhetar. Vitet mbi supë nuk mund t’ia pakësonin energjitë këtij 60-vjeçari. Dihet se Porta e Lartë, nën presionin e Fuqive të Mëdha Evropiane, dërgoi në drejtim të Kosovës një ushtri disa mijëshe të armatosur deri në dhëmbë, të kryesuar prej Dervish Pashës. Qëllimi i këtij inkursioni ishte shkatërrimi i plotë i funksionimit të Lidhjes së Prizrenit, përndryshe, vazhdimi i pushtetit turk



me dhunë, në viset shqiptare, 15 mijë ushtarë e oficerë të Portës së Lartë, mbërritën në Shkup në ditët e para të prillit 1881 dhe s’ishte e vështirë të kuptoje qëllimet e mbramë të Perandorisë Turke. Qeveria e përkohshme e kryesuar prej Ymer Prizrenit me t’u lajmëruar për mbërritjen në Shkup të kësaj ushtrie, dha kushtrim. Prej Gjakovës, Dibres, Prizreni, Lume e Vuçitërnit u mbledhën rreth 7 mijë luftëtarë të cilët, të udhëhequr nga Sulejman Vokshi, Ali Ibra, Sef Kosharja e dhjetëra burra të tjerë, nisën të organizojnë rezistencën madhore. Ata nuk do të frikësoheshin këtij sulmi, ashtu siç u ishin frikësuar qindra betejave, në disa decenie me radhë. Ymer Prizreni e Abdyl Frashëri, duke organizuar qëndresën, ndërmarin edhe disa veprime diplomatike me konsujt evropianë në Prizren, Prishtinë e Shkodër. Për më tej ata i dërgojnë edhe një memorandum Portës së Lartë duke mos harruar të shkruajnë në fund se “Shqiptarët do të mbrojnë atdheun dhe nderin e tyre deri në fund e do të ndjekin rrugën e qytetërimit”. Por, mijërat e ushtarëve dhe oficerëve turq, mijërat e grykave të zjarrit, batalionet e tëra të artilerisë dhe kalorësisë do të bënin punën e vet. Betejat e Shtimjes, Suharekës, Slivovës etj, natyrisht edhe pse përfunduan me humbje kanë vlerat e tyre të pallogaritshme në moralin dhe vetëdijen nacionale shqiptare. Ymer Prizreni, ishte dhe mbeti deri në fund krahu politik i këtyre

betejave. Ai jo vetëm që nuk u tremb, por rrëmbeu armët edhe vet, në atë moshë madhore, për t’u bërë ballë sulmeve të hordhive turke. Mbas thyerjes së rezistencës shqiptare, Ymer Prizreni, me ndihmën e disa miqve të vet shkoi në Ulqin.

Aty jeton me ndihmat e disa shqiptarëve që ia njohin jo vetëm vlerat si prijës por edhe si atdhetar i vendosur. Disa përpjekje të Portës së Lartë, për ta burgosur dështojnë ngase shqiptarët e Ulqinit e duan si babanë e vëllain e tyre, kësisoj, për pesë vjet me radhë, Ymer Prizreni, i plakur, i ligështuar, jetonte në një dhomë të thjeshtë të Ulqinit, larg familjes, të cilën Dervish Pasha ia pat mërguar në Turqi.


Në pranverën e vitit 1886, atëherë kur në trevat shqiptarë po ravijëzohet sërisht një kryengritje tjetër, në shtëpinë e birit të Prizrenit troket i dërguari i Portës së Lartë, një hoxhë prej Ulqini. Ai i thotë se nëse Ymer Efendiu do të ndikonte në Dibër, Prizren e Tetovë, tek miqtë e vet, që kjo rezistencë të mos gatuhej, do t’i falej jeta e do t’i jepeshin disa qese floriri. Por përgjigjja e burrit do të ishte: “Shko nga erdhe se edhe sikur në fron të vet, të më vëre sulltani, nuk dua të di ma, për Turqinë”. (Xh. Belegu, Lidhja e Prizrenit e veprimet e saj, Tiranë 1939, faqe 191). Disa ditë më pas, Haxhi Ymer Prizreni, do të gjendej i masakruar në shtëpinë e vet. Mbyllej kësisoj tragjikisht, një jetë trimi e cila në çdo ditë të saj, shkroi faqe atdhedashurie.



HORIZONTALISHT

3. Parafjalë, përveç
5. Çifligar polak
7. Rrugicë
9. Kollomboç
10. Qese perj pëlhure apo leshi
12. I shkretë, i mjerë, i gjorë
13. Mëma
15. Vrull
16. Ujë (frëngj.)
17. Burrë trim e bujar
19. Kalë shale
20. Banor i Spartës së lashtë
23. Që u përket arianëve, i arianëve
24. Disenjatorja frënge, Shanel
25. Vendi i magjistarit, sipas tregimit të Frank baumit
26. Heroi kombëtar, Mic
28. Afsh; zjarrmi
30. Ilaç
31. Lojë me 5 kocka
32. Inicialet e autorit Mekuli
34. Bixhoz
36. Çelës (ang.)
37. Emri i revolucionarit Vokshi
39. Vijë e lakuar e hapur (matem.)
41. Myhyri
42. Dashje; dashamirësi
43. Vend me ujë të ndenjtur, ligatë
45. Pjesëmarrje në film
46. Tokë, rajon komunal (sh. pashq.)
47. Grup prej nëntë këngëtarësh
48. Fillon

FJALËKRYQI KLASIK




VERTIKALISHT


1. Çekiç
2. Emri i heroit Prishtina
3. Djalë i ri, çun
4. Copë e vogël e diçkaje, çikërrimë
5. Kusar
6. Parafjalë, ndër
8. Kërcënon
9. Banori i Milanos
11. Simboli kimik i Tantalit
12. Vezë
14. Këngëtarja vlonjate në foto
17. Ha darkë
18. Aktorja kroate Rina
21. Klub futboll i Selanikut
22. Pohim polak
24. Mal në kufirin Shqipëri-Maqedoni
26. Shalë prej druri
27. Përemër pronor
29. Tërësi e pasurisë
30. Gurrë
33. Barbar, tiran
34. Drejtim, kahje
35. Vepër letrare
37. Parafjalë gjermane
38. Pyll
40. Qan, nxjerr lot
41. Në lartësi të vogël
44. Perëndia greke e luftës

Kakuro


e lehtë



mesatare



e vështirë




KOHA e lirë për më të rinjtë

Tetëkahëshi (bota ujore)


K	K	I	A	A	U	A	I	F	T
R	A	SH	D	K	K	N	K	I	Ë
O	U	R	SH	O	I	SH	L	O	GJ
K	B	E	A	F	P	I	E	E	F
O	P	A	L	V	N	A	L	R	N
D	A	E	L	I	I	D	T	GJ	B
I	D	M	I	E	E	DH	A	K	I
L	J	L	E	T	N	L	J	R	O
I	A	O	I	B	A	A	I	A	M
K	P	E	SH	K	A	Q	E	N	I
T	I	T	E	D	I	I	LL	Y	DH
B	R	E	T	K	O	C	A	R	J
E	I	N	I	U	G	N	I	P	E

Gjeni 18 emrat e gjallesave të dhëna me figura. Në fund do t'ju mbeten 10 shkronja, të cilat lexuar me radhë e japin grupin e gjallesave, të cilëve u takojnë ato.



Mozaiku

Plotësoni fjalëkryqin duke i shënuar fjalët e dhëna. Në fushat e hijëzuara duhet të shënoni emrin e kafshës së dhënë në foto, e cila jeton në Polin e Veriut.



Fjalët me 2 shkronja:

AA, AM, AT, ISH, PR, TK

Fjalët me 3 shkronja:

AND, APO, ARRA, BOR, ETA, JAN, OJA, RAB, REI, SAK, SUP, URE

Fjalët me 4 shkronja:

AKUJ, ARAB, ARAD, ARRIJ, IKAR, JETA, KASA, MEDA, NEMO, PARA

Fjalët me 5 shkronja:

AMATI, AVANS, BADEM, BALTA, DIANA, KALIM, KOFER, MELIS, POLEN, SALEM, SPORT, SHOFER, TIVAR


Fjalët me 6 shkronja:

BETEJA, DONIKA.



Domino

Plotësoni fjalëkryqin duke i bartur katrorët e dhëna më poshtë. Në fushat e hijëzuara do të fitoni kukullën e njohur (shih fotografinë).



U	E	L
M	R	A
	O	M

O	N	I
	E	SH
A	T	A

L	E	R
	N	I
T	A	T

B	I	
L	E	M
U		B

U	LL	A
S	A	R
	M	O

I		E	
N	E	Z	
	K	L	E

E	P	I
U	L	M
R	A	

O	I	
S	F	I
T	I	N

A	N	T
D	A	
I		A

S	A	E
E	N	T
U	T	Ë

K	U	K
E	M	I
V	A	N

A	M	P
S	A	R
E	T	

B	A	R
I		E
T	A	K

N		T
E	M	I
R	O	M

	M	A
M	O	R
Ë	L	E

M	A	N
I	R	
R	I	K

SUDOKU "killer"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Numrat e dhëna paraqesin shumën brenda sipërfaqes me vija të ndërprera.

8		24						12		
11	20		21	3	16	19		8	7	
		4	3	5		12				
20	5			18		5		13	12	
	3	5		8		6				
	12	14		9		5	7			
6	3		11	13	8			21		
	14		23			12			4	
	11		7			5				

SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnjë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".

8										
	4							8		
			8						6	
										2
5			3			7				
	6			3						
										4
										7

KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Numrat tregojnë rezultatit, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.

3+		280x	14+		6	324x	20+		112x	4
3-	2			8	3					
	13+		8	9			2+	6-	8-	
14+	1-	3+		6	8	40x				
		4+		8+		2	240x	2+		
9										
3+		11+					2+		8	
42x	2+	3+	10x				1-		8	
			3+	288x		5-			2	5
192x				8+		1	10x			

KRIPTOGRAMI

Kriptogrami zgjidhet sipas rregullit "numri i njëjtë - shkronja e njëjtë". Në fushat e hijëzuara shënoni emrin dhe mbiemrin e aktores së njohur të kinematografisë shqiptare (në foto).

1	2	3	4	5	6	7	8	7	3	5	9	4
10	3	5	11		4	1	2		4	1	2	12
13	4	13		12	3	5	14	4		2	15	7
11	2		16	17	2	3	4		2	18	19	13
2	6	4	10						20	2	21	2
22	5	6	20						18	11	7	23
5		5	3						7		24	11
	2	8	2						3	25		10
7	6	2	17						1	4	26	2
23	7	6	4						2	6	4	3
5		5	11						6	20	27	
3	23		19						4	5		20
11	3	2	13						11	3	4	28
10	4	18	4						5	11	18	2
5	8	7	11		2	7	18	5	11		29	13
13	4	18		2	16	29	2	11		30	2	15
4	29	4	6		10	3	4		31	4	13	2
11	5	1	12	5	3	2	1	5	18	11	5	11



1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	
16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31

INTEGRAMI (Problemi i Ajnshtajnit)

Profesorët dhe ngjyrat

		LËNDA					NGJ. E VETURËS				
		GJUHË SHQIPE	MATEMATIKË	BIOLOGJI	FIZIKË	KIMI	E BARDHË	E ZEZË	E KUQE	E VERDHË	NGJYRË KAFE
NGJ. E FLOKËVE	TË ZEZA										
	TË KUQE										
	TË VERDHA										
	TË BARDHA										
	NGJYRË KAFE										
NGJ. E VETURËS	E BARDHË										
	E ZEZË										
	E KUQE										
	E VERDHË										
	NGJYRË KAFE										

ARUKONE

Bashkoni me vija numrat e njëjtë. Vijat nuk guxojnë të priten dhe duhet të përfshihen të gjitha fushat!

			6									
	8		3							1		
		4									5	
	3											
		2				7						
	2	6	4			1						
	8					5						7

HITORI

Numrat që përsëriten duhet të nxihen, ashtu që në kolonat dhe rreshtet të mbeten numrat prej 1-9.

8	1	1	9	4	2	8	4	1
3	7	9	6	2	6	4	5	5
5	2	4	1	5	4	9	3	8
1	6	6	4	5	7	2	8	4
7	4	5	2	5	7	3	6	6
2	1	4	7	9	4	6	7	1
8	3	2	7	1	9	8	6	4
9	1	8	1	4	3	7	5	7
2	9	7	5	7	1	1	2	3

NONOGRAM

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat me presje (rreshtet) dhe ato njëri nën tjetrin (kolonat), tregojnë se ka pauzë në mes të fushave të nxira.

		1				1
		1	3	1	3	1
2	1					
	1					
	3					
	1					
	1	2				

Pesë profesorë në një shkollë fillore, të cilët mësojnë kroatë, matematikë, biologji, fizikë dhe kimikë, kanë flokë të ngjyrave të ndryshme: të zeza, të kuqe, të verdha, të bardha dhe ngjyrë kafe. Edhe veturat e tyre janë me ngjyra të ndryshme (e bardhë, e zezë, e kuqe, e verdhë dhe ngjyrë kafe), mirëpo asnjëra nga makinat nuk e ka ngjyrën e pronarëve të tyre. A mund të zbuloni lëndën që e jep dhe ngjyrën e veturës së çdonjërit prej profesorëve?

Të dhënat:

- Profesori me flokë ngjyrë kafe nuk drejton makinë të kuqe.
- Profesori flokëzi jep kimi.
- Profesori flokëkuq, i cili drejton makinë të gjelbër, nuk jep fizikë.
- Profesori flokëbardhë, i cili nuk drejton makinë ngjyrë kafe, jep gjuhë shqipe.
- Profesori që drejton makinë të bardhë, i cili nuk i ka flokët ngjyrë kafe, jep biologji.
- Profesori flokëbardhë nuk drejton as veturë të bardhë e as të zezë.
- Vetura e kimistit është ngjyrë kafe.

TABELA

	LËNDA	NGJYRA E VETURËS
Profesori flokëzi		
Profesori flokëkuq		
Profesori flokëverdhe		
Profesori flokëbardhë		
Profesori flokë ngjyrë kafe		

Një shtet si Serbia që me forcat shtetërore plaçkiti, dogji dhe rrënoi afro 2 700 objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare e në kuadër të tyre edhe një numër të komplekseve dhe të objekteve të shpallura si monumente kulturore-historike me rëndësi dhe vlera të veçanta, nuk e meriton që të jetë anëtare e UNESCO-s e lëre më ta pengojë pranimin e Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare

Fejz DRANÇOLLI

Akademiku serb Dobrica Qosiq konstaton: "Gënjejme për ta mashtruar veten, për ta ngushëlluar tjetrin; gënjejme nga dhembshuria, gënjejme nga turpi për t'u trimëruar, për ta fshehur varfërinë tonë. Gënjejme për arsye nderi. Gënjejme për arsye të lirisë. Gënjeshtër është pamje e patriotizmit serb, vërtetim i inteligjencës së lindur. Gënjejme me kreativitet, imagjinatë dhe inovacion. Gënjeshtër është interes shtetëror serb. Gënjeshtër është pjesë e të qenit serb. Në këtë vend secila gënjeshtër në fund pranohet si e vërtetë. Serbët shumë herë në histori i ka shpëtuar gënjeshtër". Një shtet që me egoizëm e mbron trashëgiminë në territorin vet, e përvetëson kulturën shpirtërore e materiale të tjerëve, në anën tjetër plaçkitë, djegë e shkatëron trashëgiminë kulturore si të lëvizshme ashtu edhe të palëvizshme, vlerat historike të një populli tjetër si në rastin e Kosovës, nuk bën pjesë ndër shtetet e civilizuar.

Një shtet si Serbia që me forcat shtetërore plaçkiti, dogji dhe rrënoi afro 2 700 objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare e në kuadër të tyre edhe një numër të komplekseve dhe të objekteve të shpallura si monumente kulturore-historike me rëndësi dhe vlera të veçanta, nuk e meriton që të jetë anëtare e UNESCO-s e lëre më ta pengojë pranimin e Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare.

Marrja e muzealeve nga Muzeu i Kosovës (1998) si dhe shkatërrimi gjenocidal i trashëgimisë shqiptare në Kosovë (1998-1999, por edhe më parë), plaçkitja e dokumentacionit të Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore në Prishtinë dhe moskthimi i tyre në Kosovë, nuk duhet të jetë dhe nuk është diç e panjohur për shtetet anëtare të UNESCO-s. Mirëpo, shteti gjenocidal i Serbisë këto ditë (15 shtator 2017) para ambasadorëve të vendeve anëtare të UNESCO-s u paraqit me një ekspozitë e film dokumentar, me një prezantim jo të saktë, të rrejshëm në lidhje me

Serbia në Paris kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO



“Serbët gjatë historisë së tyre shpesh kanë gënjer. Këtë më së miri na e dëshmon edhe thënia e akademikut serb Dobrica Qosiq: “Gënjejme për ta mashtruar veten, për ta ngushëlluar tjetrin, gënjejme nga dhembshuria, gënjejme nga turpi, për t'u trimëruar, për ta fshehur varfërinë tonë, gënjejme për arsye nderi. Gënjeshtër është pamje e patriotizmit serb, vërtetim i inteligjencës së lindur. Gënjejme me kreativitet, imagjinatë dhe inovacion. Gënjeshtër është interes shtetëror serb. Gënjeshtër është pjesë e të qenit serb. Në këtë vend secila gënjeshtër në fund pranohet si e vërtetë. Serbët shumë herë në histori i ka shpëtuar gënjeshtër”.

trashëgiminë e Kosovës në Paris.

Serbët gjatë historisë së tyre shpesh kanë gënjer. Këtë më së miri na e dëshmon edhe thënia e akademikut serb Dobrica Qosiq: “Gënjejme për ta mashtruar veten, për ta ngushëlluar tjetrin, gënjejme nga dhembshuria, gënjejme nga turpi, për t'u trimëruar, për ta fshehur varfërinë tonë, gënjejme për arsye nderi. Gënjeshtër është pamje e patriotizmit serb, vërtetim i inteligjencës së lindur. Gënjejme me kreativitet, imagjinatë dhe inovacion. Gënjeshtër është interes shtetëror serb. Gënjeshtër është pjesë e të qenit serb. Në këtë vend secila gënjeshtër në fund pranohet si e vërtetë. Serbët shumë herë në histori i ka shpëtuar gënjeshtër”.

Si përherë edhe kësaj radhe në Paris të Francës, Serbia vazhdon me avazin e vjetër, tradicional, garashanian (1844) shekullor, pa precedent për një shtet të ulëta për përvetësimin e trashëgimisë fetare ortodokse mesjetare në veçanti. Trashëgimia historike-kulturore si fetare ashtu edhe ajo laike që gjenden në territorin e Kosovës u takojnë kryesisht banorëve autoktonë, pra shqiptarëve dhe popujve të tjerë ardhacakë, që disa nga këto monumente shfrytëzohen edhe sot nga ata.

Propagandimi në vijimësi i këtij lloji dhe në mënyrë jo reale, jo qytetëruese me ekspozitë

dhe film të përgatitur enkas nga shteti i Serbisë që u paraqit në qendër të Parisit, në qytetin ku është edhe selia e UNESCO-s, është një prezantim bajat për shqiptarët dhe të tjerët që i njohin qëllimet e Serbisë. Kosova është shtet dhe si e tillë është njohur dhe pranuar me vendim të posaçëm edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë së Kosovës është legjitime dhe e pranuar ndërkombëtarisht, deshi apo nuk deshi Serbia. Legjitime do të jetë edhe pranimi, anëtarësimi i Kosovës në UNESCO. Serbia duhet të ecë me hapa të kohës, sa më parë aq më mirë për Serbinë dhe popullin e saj.

Të përkujtojmë se në Qendrën Kulturore të këtij shteti në Paris, pos tjerash u prezantua një material në lidhje edhe me shkatërrimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë në ditët e 17 dhe 18 marsit të vitit 2004. Të theksojmë dhe duhet përkujtuar se në marsin e vitit 2004, pas vrasjes së tre fëmijëve shqiptarë në Mitrovicë dhe djegies së Xhamisë në Beograd dhe tjetrës në Nish, më 17 mars, në Kosovë shpërthyen trazirat, (përveç viktimave të shumta kryesisht shqiptarë, të vrarë e të plagosur), dhe nga individë të paidentifikuar deri më tani, u dogjën pesë kisha dhe u demoluan dymbëdhjetë kisha të tjera ortodokse në Kosovë si dhe disa objekte banimi në Nënkananë e Prizrenit.

Pesë kishat e djegur

kryesisht ishin të ndërtuara pas okupimit të Kosovës në mes të dy luftërave botërore si dhe të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore. Asnjë kishë a kompleks me rëndësi dhe monument i periudhës paleokristiane të shekujve IV-VI, (kur serbët as që dinin dhe as që ishin në territorin e Kosovës së sotme, ata ishin paganë dhe në fenë krishtere filluan të konvertohen diku rreth shek. IX e që zgjati edhe gjatë sundimit Nemanjid) përkatësisht të riadaptuara dhe të përshtatura liturgjisë së kohës mesjetare të shek. XIII e XIV nuk u demtuan, nuk u demoluan dhe nuk u dogjën.

Është me interes të veçantë, dhe duhet theksuar se gjatë luftës çlirimtare (1998-1999) në zonat e kontrolluara nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, nuk u dogj dhe nuk demtua asnjë objekt fetar ortodoks në territorin e Kosovës.

Njëherësh, duhet cekur se nga autori i tekstit u përgatit publikimi në gjuhën angleze “Monuments of Kosova”, botoi MKRS, Prishtinë, 2005. Publikimi në fjalë u paraqit në vitin 2005, në Selinë e UNESCO-s, në Paris, përkatësisht me shkatërrimin e trashëgimisë, monumenteve të Kosovës nga ana e pushtetit serb, duke zënë në gojë edhe trazirat e marsit të vitit 2004. Po ashtu, nga autori i njëjtë u paraqit dhe u hap ekspozita e fotografive të monumenteve të shkatërruara, IHKL, Prishtinë, 2012. Kjo ekspozitë u prezantua në disa shtete si në Shqipëri (Tiranë), Turqi (Ankara, Stamboll dhe Bursa) në

Austri (Vjenë) e Prishtinë. Këtu u prezantua një pjesë e djegieve, rrënimëve, dëmeve dhe përgjithësisht barbaria ndaj monumenteve, trashëgimisë kulturore-historike shqiptare të kryera nga forcat policore, ushtarake e paramilitare serbe gjatë luftës së viteve 1998-1999. Po nga autori i njëjtë në botim të IHKL-së dolën edhe dy monografi: “Monumentet e shkatërruara në Kosovë 1998/99”, Prishtinë, 2015, dhe “Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998/99, Prishtinë, 2017. Monumentet e shkatërruara të trashëgimisë kulturore, të trajtuara në këto botime, u takojnë shek. XV-XIX dhe XX. Këto publikime janë dëshmi të mjaftueshme për ta demaskuar prezantimin e tendencioz të Serbisë në Paris.

Shkatërrimet e monumenteve ishin të planifikuara nga shteti serb dhe kishin për qëllim zhdukjen e komplekseve urbane-arkitektonale, të ekzemplarëve të veçantë të objekteve të vjetra qytetare të banimit etj., që ishin të valorizuara dhe kishin vlera me rëndësi historike, artistike, arkitektonale e mjedisore, kishin për synim zhdukjen e gjurmëve autoktone të lokaliteteve arkeologjike, veçmas të gjurmëve të kulturës ilire-arbërore-shqiptare. Kjo u pa sheshazi nga ajo që ndodhi pas luftimeve të para në Kosovë në vitet 1998-1999. Këto shkatërrime të trashëgimisë kulturore si fetare ashtu edhe laike, publike e individuale as që u përmendën në këtë film “dokumentar” të shtetit serb. Por, një gjë të tillë as që e kemi pritur nga Serbia.

Shteti i Kosovës nuk duhet të rrijë duarkryq, duhet të veprojë kundër gënjeshtërve të shtetit serb meqë, në këtë aspekt edhe posedojmë fakte, dëshmi dhe publikime të pamohueshme për vjedhje dhe shkatërrimin e trashëgimisë historiko-kulturore shqiptare. Sot, si pasojë e këtyre shkatërrimeve një numër i madh i tyre nuk ekzistojnë. Një shkatërrim i përmasave të këtilla ndaj trashëgimisë nuk duhet të harrohet por, përherë të përkujtohen. Forcat shtetërore të Ser-

bisë, përkatësisht të mbetjes së ish-Jugosllavisë, ushtria, policia dhe paramilitarët i dogjën 218 xhami, 6 teqe, 2 tyrbe, 4 medrese, 4 mejtepe, 1300 dyqane (në Çarshinë e Vjetër të Pejës, Gjakovës dhe të Vushtrrisë), 685 kulla, 33 shtëpi të arkitekturës banesore tradicionale, 2 hamame, 1 urë, 560 metra kub piktura murale, 8 kisha katolike e shumë ndërtime të tjera me vlera të trashëgimisë historike - kulturore e fetare, duke mos i përmendur sendet e lëvizshme që ishin pjesë e enteriereve të objekteve.

Këto fakte të pamohueshme duhet t'i tregojmë përherë, t'ua përkujtojmë shteteve anëtare të UNESCO-s, (edhe pse ata e dinë, zyrtarisht janë të informuar, përmendim këtu rastin se gazeta parisienne “Le Monde”, në dhjetor të vitit 1999, ka biseduar dhe shkruar për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore me ish-drejtorin i IKMMK, autorin e këtij shkrimi.

Shteti i Serbisë, në kuadër të ish-Jugosllavisë edhe pse i ka ratifikuar konventat ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e vlerave kulturore, ajo nuk i zbatoi në asnjë rast. Nuk e zbatoi Konventën e Hagës (1954) për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Gjatë Luftës. Nuk i ka zbatuar as Konventat e Konferencës Gjenerale të Kombeve të Bashkuara për Arsim e Shkencë, të mbajtur në Paris në vitin 1972 etj. Pra, çfarë morali dhe çfarë të drejte ka Serbia të na shtet mend në zemrën e kulturës dhe të artit botëror në Paris?! Serbia këtë e di, por kur gjejnë...

Për sjellje dhe veprime barbare, anticivilizuese ndaj vlerave, kulturave, monumenteve shqiptare që kishin për qëllim zhbërjen e kulturës dhe të identitetit shqiptar duhet të ndëshkohet Serbia e jo të pësojë shteti i Kosovës. Këtë duhet ta dinë shtetet anëtare të UNESCO-s e nëse ato kanë harruar duhet t'ua përkujtojmë dhe vetëm t'ua përkujtojmë... Barbarizmi që e bëri Serbia ndaj trashëgimisë, kulturës dhe identitetit shqiptar, nuk është krim vetëm ndaj kulturës së popullit në fjalë, por është krim edhe ndaj thesarit botëror. Me këto shkatërrime nuk rrënohet vetëm trashëgimia dhe arti i një rajoni dhe i një populli, por një pjesë e krijimtarisë shekullore të trashëgimisë botërore.

(Autori i shkrimit është historian i artit, këshilltar shkencor në Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Prishtinë).



Në të njëjtin nivel me ne, për sa i përket divorceve janë Italia, Greqia dhe Turqia. Vendet e rajonit janë pjesë e grupit të vendeve me normë më të ulët të divorceve për 100 martesë

Haradinaj përsërit: Vija kufitare është në Çakorr



Kreu kosovar i Ekzekutivit, Ramush Haradinaj, në kuadër të fushatës që të enjten e ka çuar atë në Podujevë, ka folur edhe njëherë për demarkacionin. Sipas tij, po punohet për zbatimin e MSA dhe drejt liberalizimit të vizave dhe demarkacionit. Sa i përket kësaj të fundit, që lidhet me

demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, ai garantoj se vija kufitare me Malin e Zi është në Çakorr. "Nuk ka votë Kosova për këtë version, kjo është e vërtetë. Kush doni me ia qit lapsin, e gjeni që nuk janë dy të tretat për këtë version. S'mund të votohet kështu", ka thënë Haradinaj. "Ata që janë në Komision, ata e gjejnë të vërtetën e atë të vërtetë ne ose do ta bëjmë marrëveshjen me Malin e Zi, ose nuk ka marrëveshje. Nuk ka marrëveshje të njëanshme për kufi. Marrëveshja është e dyanshme".

Shorti zgjedh nxënësin shqiptar për ngritjen e flamurit grek në festën e çlirimit, grekët bojkotojnë paradën

Ngritja e flamurit për përvjetorin e çlirimit të qytetit të Kozanit në Greqi do të bëhet nga një nxënës shqiptar, dhe për këtë arsye prindërit e fëmijëve të tjerë kanë kundërshtuar dhe nuk do të lejojnë fëmijët të marrin pjesë në paradë. Qyteti i Kozanit në Greqi në 11 tetor qyteti do të festojë çlirimin dhe nëpër shkolla është zhvil-


luar shorti për caktimin e nxënësve të shkollave të cilët do të ngrënë flamurin grek ditën e paradës së përvitshme. Sipas Kozanmedia, shorti i ra një nxënësi shqiptar, i cili sipas mediave është nxënës i dobët dhe sipas shumë prindërve të tjerë grekë ai nuk është i denjë për të ngritur flamurin pasi është shqiptar.

Prindërit protestojnë duke mos paraqitur fëmijët e tyre as në paradën e qytetit në 11 tetor e as në paradën kombëtare në 28 tetor, nëse ngritës dhe mbajtës i flamurit do të jetë një nxënës shqiptar. Ka dhe disa prindër të cilët kanë problem që fëmija është shqiptar dhe dëshirojnë që flamurin ta ngrënë në paradë vetëm

fëmijë të lindur në Greqi. Për herë të parë në Greqi Ministria e Arsimit ka publikuar një vendim ku shprehet se flamurin grek ditën e Çlirimit do ta ngrënë nxënës me short dhe jo në bazë të vlerësimit të notave si ka qenë më parë, për të ruajtur një klimë harmonike dhe të barabartë mes nxënësve të klasës.

Divorcet, Shqipëria po hyn ndër vendet me normë të lartë

Shqipëria ka hyrë në zonën e kuqe, në grupin e vendeve të cilët kanë një normë divorci 30-39 për 100 martesë. Në të njëjtin nivel me ne, për sa i përket divorceve janë Italia, Greqia dhe Turqia. Vendet e rajonit janë pjesë e grupit të vendeve me normë më të ulët të divorceve për 100 martesë



Divorci është një proces i gjatë, i lodhshëm, i kushtueshëm dhe shpeshherë me pasoja të rënda shoqërore. Por, gjithnjë e më shumë martesë po shkojnë drejt divorcit në Shqipëri duke bërë që Shqipëria të hyjë në zonën e kuqe të vendeve që kanë normë të lartë të tyre, sipas një harte globale, shkruan Monitor. Sipas të dhënave më të fundit të publikuara nga Instituti i Statistikave, në 100 martesë në Shqipëri 31 shkonin në ndarje, me një rritje të ndjeshme në krahasim me vitin e mëparshëm, kur ky tregues ishte rreth 22. Në këtë mënyrë, Shqipëria ka hyrë në zonën e kuqe, në grupin e vendeve të cilët kanë një normë divorci 30-39 për 100 martesë. Në të njëjtin nivel me ne, për sa i përket divorceve janë

Italia, Greqia dhe Turqia. Vendet e rajonit janë pjesë e grupit të vendeve me normë më të ulët të divorceve për 100 martesë. Sipas hartës së publikuar nga Wikipedia, rekord për numrin më të lartë të divorceve me mbi 60 divorce për 100 martesë e mban Spanja dhe Portugalia dhe vendet e Beneluksit. Të lartë numrin e divorceve e kanë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Franca dhe Zvicra, si dhe Rusia, ku norma e divorceve varion nga 50-59 divorce në 100 martesë. Ndër arsyet kryesore për rritjen e divorceve në Spanjë, ishte kriza ekonomike. Rritja shumë e madhe e divorceve bëri që qeveria spanjolle të shkurtojë në kohë procedurën për divorce, ku një vit, kohëzgjatja e procedurës u

shkurtua brenda ditës. Pjesë e grupit të vendeve me normë të ulët të divorcesh, sipas të dhënave në hartë, me normë 0-9 divorce, janë Kili dhe Kolumbia, disa vende të Afrikës dhe Azisë. Arsyet kryesore, që japin ekspertët ligjorë dhe ata të fushës psikologjike, lidhen fort me shoqërinë shqiptare ndër vite: dhuna, varfëria, emigracioni, mblesëritë. Por, duket se të tjera arsye po bëhen të dukshme, si rritja e pozicionit të femrës në shoqëri, diferencat në arsim dhe në prioritet, apo edhe bixhozi etj. Divorci është një proces i gjatë, i lodhshëm, i kushtueshëm dhe shpeshherë me pasoja të rënda shoqërore. Psikologët vlerësojnë se divorci është një proces i cili ka një ndikim afatgjatë në jetën e ish-partnerëve,

duke i cenuar ekonomikisht. Kjo shkakton rënie të standardit të jetesës së mëparshme dhe në rastin e individëve në karrierë, ndikim në produktivitet. Stresi është ndër pasojat e divorcit, që shpeshherë është i gjatë dhe financiarisht i vështirë. Psikologët pranë Gjykatës së Tiranës tregojnë se dy nga katër nëna të divorcuara nuk marrin pagesën e plotë të mbështetjes së fëmijës. Disa të tjera detyrohen të braktisin punën që kanë pasur më parë, në kushtet e kërkimit të një pune të përshtatshme edhe me oraret e fëmijëve (ekonomikisht nuk përballohet prania e një dadoje apo kopshti/shkolle private). Gjatë procesit të kërkimit të punës, shpesh hasin paragjykimet apo vështirësi.



Pacoli i kërkon Mogherinit liberalizimin e vizave

Ministri i jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacoli, të parës së diplomacisë së Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, i ka thënë se "liberalizimi i vizave është hapi vendimtar që duhet kryer tani, sepse ndikon fuqishëm në perspektivën e të rinjve kosovarë që janë të edukuar mirë, me mendje të hapur dhe për një Kosovë me frymë të re evropiane". "Edhe shëfja për politikë të jashtme të BE-së, ka ndarë të njëjtin vlerësim për rininë dhe shoqërinë kosovare, duke theksuar se viti i dytë i mandatit të këtij Komisioni do të jetë vendimtar për integrimin evropian të ra-

jonit, të Kosovës dhe përkrahës të liberalizimit të vizave në veçanti", thuhet në kumtesë. Në vazhdim të takimit është diskutuar edhe për fazën e re të dialogut për normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë. Në lidhje me këtë çështje, Pacoli ka rikonfirmuar përkushtimin e institucioneve të Kosovës për dialog, duke konsideruar se është shumë e rëndësishme që të ketë një afatizim kohor, përdërisa Mogherini ka kërkuar zotim nga pala kosovare për implementimin e marrëveshjeve të arritura deri më tash.

Njerëzit ikin më së shumti nga Siria, Kroacia, Kosova...

Kosova dhe Lituania kanë pasur rënie të numrit të banorëve nga 1.1 në 0.9 për qind, derisa Kroacia ka zënë vendin e gjashtë me një rënie prej 0.8 për qind

Forumi Ekonomik Botëror (World Economic Forum), ka publikuar të dhëna shqetësuese për vendet me rënie më të madhe të numrit të njerëzve në botë. Kroacia gjendet në mënyrë dramatike në vendin e gjashtë, së bashku me

Sirinë e shkatërruar dhe Kosovën. Në listë prin Andorra, por meqenëse Andorra ka më pak se 80 mijë banorë, ikja e secilit person përbën problem të madh. Njerëzit në mënyrë masive braktisin vendet e tyre kur gjendja e tyre bëhet e vështirë - për shkak të krizës ekonomike dhe kërcënimit të jetës së tyre, siç është edhe rasti i Sirisë që është shkatërruar nga lufta. Njerëzit janë duke u larguar nga Porto Riko në mënyrë masive, për shkak të recesionit shumëvjeçar dhe përqindjes së madhe të



papunësisë. Sa i përket Litanisë, ky vend ka regjistruar një numër të madh të qytetarëve që janë larguar për të shkruar në Britani të Mad-

he. Në krye të kësaj liste është Andorra, popullsia e të cilës është zvogëluar për pothuajse një të pestën gjatë këtyre dhjetë viteve të fundit. Sipas të

dhënave të Bankës Botërore, numri i banorëve në Andorrë është zvogëluar për 15 mijë nga viti 2009 deri më 2015, kurse vetëm gjatë vitit 2015 është zvogëluar për 3.2 për qind. Në vend të dytë renditet Porto Riko, që para dy viteve ka pësuar rënie të numrit të banorëve për rreth 1.7 për qind, kurse pas këtij vendi është pozicionuar Siria e prekur nga lufta. Kosova dhe Lituania kanë pasur rënie të numrit të banorëve nga 1.1 në 0.9 për qind, derisa Kroacia ka zënë vendin e gjashtë me një rënie prej 0.8 për

qind. Sipas Forumit Ekonomik Botëror, vendet e Evropës Lindore dhe të ish-Bashkimit Sovjetik janë vendet me rënie më të madhe të popullsisë për shkak të nivelit të ulët të natalitetit dhe emigracionit të shkaktuar nga problemet ekonomike. Por, në listë është edhe Siria e cila pothuajse është shkatërruar e tëra nga lufta pesëvjeçare. Ngecje ka edhe Kosova, si shteti më i ri, që vazhdimisht po ka probleme me fqinjën e saj Serbinë që nuk e ka njohur pavarësinë e këtij vendi.



Nxitja e urrejtjes, BE iu jep ultimatum mediave sociale

Facebook, Twitter dhe medie të tjera sociale kanë marrë një ultimatum nga Bashkimi Evropian: eliminoni përmbajtjet e urrejtje nga platformat tuaja, ose do të përballeni me pasojat ligjore! Rregullatorët evropianë kërkojnë prej vitesh që kompanitë e mediave sociale të eliminonin postimet raciste dhe të dhunshme nga platformat e tyre, e duket se tashmë iu është sosur durimi. Facebook, Twitter, Microsoft, Google janë zotuar se do të bëjnë më shumë, madje në maj të vitit 2016 prematuan se do të rishikojnë shumicën e postimeve problematike të sinjalizuara nga përdoruesit brenda 24 orësh, e se do të eliminonin përmbajtjet e jashtëligjshme. Por Komisioni Evropian tha se këto kompani kanë dështuar në përpjekjet e

tyre dhe nuk veprojnë shpejt sa duhet. Sipas KE-së, mediave sociale në shumë raste i duhet më shumë se një javë që të eliminonin përmbajtjet e jashtëligjshme të postuara në platformat e tyre. Brukseli njoftoi se, nëse për pak muaj situata nuk ndryshon, do të miratojë ligje për të gjobitur këto kompani. Dihet që BE-ja është tejet e ashpër në raste të tilla. Mjafton të përmendim gjobën prej 2.8 miliardë dollarësh ndaj Google për monopol. Por disa vende evropiane nuk kanë më as durimin të presin BE-në. Në maj, Gjermania miratoi ligjin që gjobit me 50 milionë euro Facebook-un apo të tjerë, që nuk eliminonin brenda 24 orësh postime raciste dhe me urrejtje, ndërsa Britania e Madhe dhe të tjerë janë duke i konsideruar këto masa.



Spastrimi etnik në Mianmar largoi 84 për qind të muslimanëve

Në Mianmar, ku 135 grupe etnike njihen zyrtarisht, budistët fanatikë kundërshtojnë njohjen zyrtare të muslimanëve të Arakanit

Mbi 80 për qind e muslimanëve të Arakanit të cilët që nga vitet e 70-ta i janë nënshtruar tiranisë dhe shtypjeve sistematike në Mianmar, kanë braktisur trojet e tyre në këtë vend dhe kanë migruar në shtetet e rajonit, raporton Anadolu Agency (AA). Sipas zëdhënëses së Komisarariatit të Lartë për Refugjatë pranë Kombeve të Bashkuara (UNHCR), Duniya Aslam Khan, mbi 500 mijë muslimanë të Arakanit kanë shkuar në Bangladesh që nga 25 gushti, për shkak të incidenteve të fundit të dhunës në Arakan. Muslimanët e Arakanit, të cilët nga qeveritë e Mianmarit janë konsideruar si emigrantë të ardhur nga Bangladeshi, në dokumente zyrtare ata emërohen si "Bengali". Përmes

një ligji të miratuar në vitin 1982 ata humbën të drejtën për shtetësi dhe llogariten si popull "pa shtet", teksa Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) i konsideron si "pakica më e persekutuar". Ata njëkohësisht përballen me dhunë dhe me diskriminim ligjor, ekonomik dhe shoqëror. Në Mianmar, ku 135 grupe etnike njihen zyrtarisht, budistët fanatikë kundërshtojnë njohjen zyrtare të muslimanëve të Arakanit. Përleshjet që shpërthyen në vitin 2012 në Arakan mes budistëve dhe muslimanëve, aktualizoi dramën e muslimanëve Rohingya. Gjatë incidenteve, mijëra njerëz humbën jetën, shumica muslimanë, ndërsa qindra shtëpive dhe bizneseve iu vu zjarri. Në operacionet e ushtrisë së Mianmarit që nisën tetorin e vitit të kaluar pas sulmeve ndaj disa pikave policore, muslimanët u ballafaquan me dhunë dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Caku kryesor i operacioneve u bënë civilët. Për shkak të trysnive sistem-

atike, muslimanët e Arakanit prej vitesh strehohen në vendet e rajonit, duke migruar në mënyrë që të mbijetojnë dhe të jenë të sigurt. Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Migrimin dhe të dhënave të përafërta të përpiluara nga deklaratat e zyrtarëve të vendeve të rajonit, që nga vitet e 70-ta e deri në fillim të vitit 2017, mbi një milion e 100 mijë muslimanë të Arakanit janë detyruar t'i braktisin trojet e tyre. Në këtë periudhë, 400 mijë muslimanë të Arakanit kanë migruar në Bangladesh, mbi 300 mijë në Pakistan, 300 mijë në Arabinë Saudite, 55 mijë në shtetet e tjera të Gjirit, mbi 100 mijë në shtetet e Azisë së Paqësorit me në krye Malajzinë dhe dhjetë mijë në Indi, përmes rrugëve legale apo ilegale. Sipas një raporti me titull "Kriza e Komunitetit Rohingya" e Drejtorisë së Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e Civilëve dhe Ndhim Humanitare pranë Komisionit Evropian, numri i përafërt i popullsisë muslimane në Arakan në fillim të vitit

2017 ka qenë 800 mijë. Data 25 gusht 2017 u bë pikë kthese për muslimanët e Arakanit. Ushtria e Mianmarit dhe budistët radikalë, duke u arsyetuar me disa sulmet ndaj pikave kufitare në Arakan, filluan të ushtrorin dhunë masive. Sipas të dhënave të fundit të Organizatës Ndërkombëtare të Migrimin (IOM), mbi 500 mijë muslimanë të Arakanit kanë ikur në Bangladeshin fqinj që nga 25. Në këtë mënyrë, numri i muslimanëve Rohingya në Bangladesh ka kaluar në mbi 900 mijë. Pas ikjeve të fundit drejt Bangladeshit, supozohet se afër një milion e 600 mijë muslimanë të Arakanit ndodhen në shtetet e rajonit, kurse 300 mijë ende janë në Arakan. Sipas këtyre të dhënave, 84 për qind e gjithsej 1.9 milionë muslimanëve të Arakanit kanë braktisur Mianmarin që nga vitet e 70-ta, ndërsa kanë mbetur vetëm 16 për qind. Këto shifra tregojnë se muslimanët e Arakanit përballen me spastrim etnik.

ISIS-i thotë se "kalifi" është gjallë



Grupi ekstremist, Shteti Islamik (IS), e ka transmetuar atë që thotë se është një incizim i ri audio i liderit të vet, Abu Bakr al-Baghdadi. Data e incizimit 46 minutësh, që u paraqit dje nëpërmjet organizatës së lajmeve

të ndërlidhur me IS-in, Al-Furqan, nuk është e qartë. Në këtë incizim, folësi i cili tingëllon skur lideri i IS-it, duket se u referohet kërcënimeve aktuale të Koresë Veriore kundër Japonisë dhe Shteteve të Bashkuara. Ai, po ashtu, flet për luftërat për bazat e forta të IS-it në qytetin Mosul, të cilin forcat e Irakut e kanë rimarrë në muajin korrik. Ushtria e Rusisë ka thënë në muajin qershor se po përpiqej ta verifikonte nëse ai ishte vërtetë gjatë një sulmi ajror të Rusisë në Siri. Një komandant ushtarak amerikan tha muajin e kaluar se lideri i IS-it me gjasë është ende gjallë.

Mbështesim integritetin territorial të Irakut dhe Sirisë

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, pas takimit me homologun e tij rus, Vladimir Putin, deklaroi se referendumi kurd në Irak nuk ka legjitimitet dhe se mbështesin integritetin territorial të Irakut dhe Sirisë

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan pas takimit me homologun e tij rus Vladimir Putin deklaroi se referendumi kurd në Irak nuk ka legjitimitet dhe se mbështesin integritetin territorial

të Irakut dhe Sirisë. "Për fat të keq, rajoni ynë po bëhet shumë më i brishtë në periudhën e fundit. Referendumi kurd nuk ka legjitimitet nga pikëpamja e Kushtetutës së Irakut dhe ligjit ndërkombëtar. Për fat të keq, pavarësisht nga të gjitha vërejtjet miqësore, Administrata rajonale ka bërë një gabim të madh duke organizuar referendumin. Siç kemi thënë gjithmonë, askush nuk ka të drejtë të hedh zjarr, të përshkallëzojë tensionet në rajonin tonë, për hir të interesave personale afatshkurtra", tha Erdogan në rezidencën presidenciale në Ankara ka mbajti një konferencë

të përbashkët për media me presidentin rus Putin. "Si Turqia ashtu edhe Rusia, kemi konfirmuar edhe një herë vendosmërinë tonë për të vazhduar bashkëpunimin e ngushtë dhe për të ruajtur vullnetin tonë të përbashkët që konflikti i Sirisë të zgjidhet me rrugë politike", theksoi Erdogan në lidhje me problematikën e Sirisë. Duke vënë në dukje se me Putinin kanë diskutuar çështjet rajonale, përfshirë Irakun dhe Sirinë, Presidenti Erdogan tha se "Ne jemi dakord për integritetin territorial të Irakut dhe edhe të Sirisë". Ndërsa presidenti rus Putin tha se me krijimin e



"zonave jokonfliktuale" në Siri i ka dhënë një hov të rëndësishëm procesit të Gjenevës. Pasi ka vënë

theksin se ka qenë i vështirë krijimi i "zonave jokonfliktuale" në Siri, presidenti Putin theksoi se

me iniciativën dhe vullnetin e presidentit Erdogan kanë arritur një sukses të rëndësishëm.



Liga e parë, java e 9

Shkupi beson në rezultat pozitiv ndaj Vardarit

Me derbin e madh mes dy rivalëve të mëdhenj KF Vardar dhe FC Shkupi, e cila do të zhvillohet të dielën në "Filipi i Dytë" në Shkup, përfundon pjesa e parë në Ligën e parë futbolistike të Maqedonisë. Pos këtij dueli, të shtunën na presin edhe dy përballje tjera interesante, ajo në Manastir mes Pelisterit dhe Shkëndijës dhe në Tetovë, Renova takohet me Pobodën



Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 29 shtator – Ish-kampionin e trefishtë FC Shkupi të dielën e pret një ndeshje jashtëzakonisht e vështirë, duke marr parasysh se takohet me rivalin e saj më të madh KF Vardarin që është edhe kampion aktual të Maqedonisë. Djemtë e trajnerit Ardian Nuhui kanë një seri pozitive, ku pas xhiros së 4 nuk kanë pësuar disfatë, respektivisht kanë tre fitore dhe dy barazime. Edhe pse do të jetë vështirë, bardhekaltrit thonë se në "Filipi i Dytë" do të shkojnë në maksimumin dhe të kthehen me kokat lartë nga kjo përballje. "Jemi edhe më tej në seri pozitive të rezultateve edhe pse të mërkurën e kishim mundësinë e mirë të për të fituar, por që nuk kishim koncentrimin për finalizim të shumë rasteve. Për këtë kohë sa kishim mendoj se kemi punuar mirë edhe pse

është evidente se këtë muaj kemi shumë ndeshje të zhvilluara. Por, shpresoj që të japim maksimumin dhe të kthehemi kokëllartë edhe nga dueli i të dielës kur do të luajmë ndaj Vardarit. Mendoj se të gjitha ekipet ekziston lodhje, por mendoj se vendimtare do të jetë koncentrimi në finalizimin e rasteve dhe përqendrueshmëria në mbrojtje dhe mesfushë", deklaroi shtylla e mbrojtjes së skuadrës nga Çairi, Sedat Berisha. Ndryshe, lodhja tek futbolistët e Vardarit është dukshme më e madhe, duke marr parasysh se ky ekip të enjten luajti ndaj Rozenborgut në kuadër të xhiros së dytë të Liga Evropës, një mundësi e mirë kjo për skuadrën e Shkupit, pavarësisht faktit se Vardari posedon lojtar një fond të mjaftueshëm të lojtarëve për tu përballur në tre fronte, kampionat, Liga Evropë dhe Kupën e Maqedonisë, ku do të për-

DYSHET:	
E shtunë:	
Skopje – Rabotnički	
Renova-Pobeda	
Pelisteri – Shkëndija	
Sileksi – A.Pandev	
E diel	
Vardari - Shkupi	

ballet pikërisht ndaj Shkupit.

Siç thamë përballja tjetër interesante do të zhvillohet në Manastir, ku Pelisteri do të sfidon liderin aktual Shkëndijën. Favorit për tre pikë në bazë të rezultateve dhe faktit se si po funksionon ekipi në tetë xhirot e kaluar, janë djemtë e trajnerit Qatip Osmani. Por, rolin e favoritit ata duhet ta dëshmojnë në fushën e gjelbër, ku sigurisht se nuk do ta kenë lehtë, duke marr parasysh se Pelisteri nuk pëson lehtë kur luan para tifozëve të saj. Sikurse në çdo ndeshje, kuqezinjtë edhe ndaj Pelisterit udhëtojnë për ti fituar ndeshjen. "Respekt

për skuadrën e Pelisterit, pasi është një ekip i përpërshtatshëm. Por, ne në secilën ndeshje shkojmë në fitore, kështu do të jetë edhe në Manastir. Do të hyjmë maksimalisht të përgatitur dhe të koncentruar dhe shpresoj se tre pikët do të na takojnë neve", deklaroi për gazetën KOHA, sulmuesi Marjan Radeski.

Ndërkohë, skuadra e Renovës assesi nuk po mundet të merr veten pas fillimit të dobët. Pas barazimit 1-1 ndaj Shkupit, në mesjavë bardhekaltrit humbën nga Shkëndija në derbin lokal me 3-0. Kundërshtari i tyre i ardhshëm do të jetë Pobeda, në të cilën djemtë e trajnerit Vlatko Kostov nuk duhet ti lejojnë vetes edhe një dështim dhe gjërat do të vështirësoheshin edhe më shumë pa marr parasysh se deri në fund ka edhe shumë ndeshje për tu luajtur. Të gjitha ndeshjet e javës së 9-të do të luhen të dielën në ora 15.00.



KB Shkupi zyrtarisht pjesë e Ligës së parë

Shkup, 29 shtator – Klubi i Basketbollit Shkupi edhe zyrtarisht në sezonin e ri do të jetë pjesë e elitës së basketbollit vendor. Lajmi u konfirmua edhe nga KB Shkupi. "Klubi i Basketbollit Shkupi do të garojë në Ligën e parë për meshkuj në sezonin 2017/2018 dhe e dorëzon vendimin e saj që të merr pjesë në Ligën e parë meshkuj për sezonin 2017/18. Në përputhshmëri me vendimet për zgjerimin dhe plotësimin e Ligës së parë e sjell në kuadër të Këshillit Drejtues të FBM-së", thuhet në kumtesën e klubit shqiptar e dërguar deri te FBM-së. Derisa, rreth kësaj ka folur edhe trajneri i KB Shkupi, Enver Miftari. "Po në vendimin që na e dërgoi Federata pas aplikimit që e bëmë që të jemi

pjesëmarrës në Superligë, KB Shkupi i ktheu përgjigjen pozitive dhe pranua që të jemi pjesë e elitës së basketbollit vendor. Pas bisedimeve që i kishim me Kryetarin e Komunës së Çairit, Izet Mexhiti na u dha mbështetja për ndihmë financiare që na nevojitet për të marr pjesë në Superligë. Hapin e parë e kemi mbaruar, tash vjen hapi i dytë dhe ajo është gjetja e sponsorëve, për shkak se koha është shumë e shkurtër derisa ne në fillim do të luajmë me lojtar të cilët i kemi për momentin. Ndërkohë, që do të punojmë edhe në gjetjen e lojtarëve të rinj dhe trajner", thotë për gazetën KOHA, Miftari, i cili shpreson se biznesmeni turk me të cilin gjatë kohë janë në bisedime do ta merr ta udhëheq KB Shkupin. (B.K.)



Panuçi zbardh listën për Spanjën e Italinë

Rikthehen Xhakën, Cikaleshin, Kaçen e Lenjanin, debuton Ndoj

Risi të rëndësishme në listën për dy ndeshje tejet të rëndësishme me peshat e mëdha të futbollit botëror, Italinë dhe Spanjën. Lista e trajnerit të Kombëtares Kuqezi, Kristian Panuçi për dy takimet e radhës ka lajme të mëdha, i pari, ai i rikthimit të Taulant Xhakës. Mesfushori 26-vjeçar i Bazelit nuk ishte grumbulluar me Kombëtaren që pas atij takimi me Italinë në marsin e kaluar, pas largimit nga grumbullimi që solli edhe polemikat publike me trajnerin e asaj kohe Khanni De Biasi. Gjithsesi në mënyrë konstante gjatë kësaj periudhe Xhaka ka këmbëngulur në lidhjen e

tij të fortë me ngjyrat kuqezi, dhe tanimë rikthehet për dy takime të rëndësishme maksimale. Në Kombëtare vjen sërish edhe Sokol Cikaleshi, por ai është një rikthim i paralajmëruar me Panuçin që kishte bërë të ditur se vendimi për ta lënë jashtë kishte të bënte vetëm për ndeshjet me Lihtenshtejnin dhe Maqedoninë. Rikthim i rëndësishëm padyshim ai i Ergys Kaces me mesfushorin e PAOK që bashkohet sërish me shokët e Kombëtares pas një mungese relativisht të gjatë duke u vënë për herë të parë në dispozicion të trajnerit të ri Panuçi. Shikon sërish Kombëtaren edhe Ermir Len-



jani, që pas transferimit te Sion ka gjetur dhe minutat e aktivizimit, kusht i qenësishëm për ftesën në ekipin Kombëtar. Për sa i përket herëve të para, emri për t'u shënuar është ai i Emanuele Ndo-

jit, mesfushorit 20-vjeçar të Breshës që pas eksperimenteve me përfaqësueset e moshave tërëritet për herë të parë me Kombëtaren A. Lajm përbëjnë padyshim edhe mungesat, e lehtë të konstatohen ato

PORTIERË: Etrit Berisha, Thomas Strakosha, Alban Hoxha;
MBROJTËS: Ansi Agolli, Arlind Ajeti, Mërgim Mavraj, Berat Gjimeshi, Elseid Hysaj, Frederic Veseli, Hysen Memolla, Ivan Baliu;
MESFUSHORË: Migjen Basha, Andi Lila, Ledian Memushaj, Burim Kukeli, Eros Grezda, Ermir Lenjani, Taulant Xhaka, Ergys Kaca, Odise Roshi, Emanuele Ndoj;
SULMUES: Liridon Latifi, Azdren Llullaku, Valon Ahmedi, Armando Sadiku, Sokol Cikaleshi.

të Jahmir Hykës dhe Bekim Balajt, me sulmuesin shkodran që është kthyer vetëm para pak ditësh nga dëmtimi me Panuçin që me sa duket ka gjykuar se ende nuk është në formën optimale. Për sa i përket pjesës tjetër të listës, janë tre emrat e zakonshëm për portën, Berisha,

Strakosha e Hoxha, konfirmim në repartin e mbrojtjes për të rinjtë Memolla e Balliu që u ftuan për herë të parë muajin e kaluar, në mesfushë spikasin rikthimet e shumta, ndërkohë që në sulm pa Balajn peshën e repartit do ta mbajnë Sadiku, Cikaleshi, Llullaku e Valon Ahmedi.



Asensio ka rinovuar kontratën me Real Madridin deri në vitin 2023. Sipas "AS", klauzola do të jetë 500 milionë euro, i cili me kontratën e re do të ketë kushte më të mira ekonomike. Asensio u transferua në Madrid në vitin 2014 ku për dy sezone qëndroi i huazuar në Majorka e Espanjoli

Nuk janë të pakta rastet kur regjimi i ka dënuar ashpër sportistët pas dështimeve në arenat ndërkombëtare dhe një i tillë është edhe izolimi i të gjithë kombëtares së futbollit pas dështimit të turpshëm në Kupën e Botës 2010. Situata nuk ka ndryshuar aspak sepse edhe në ditët e sotme, një profesionist e ka shumë të vështirë të luajë në vendin komunist

Koreja e Veriut është ndoshta shteti që momentalisht ngjall më shumë kurozitet në mbarë planetin. Testimi i raketave balistike me rreze të gjerë dhe kërcënimi nuklear që i kanoset planetit nga lideri Kim Jong Un, e kanë kthyer vendin e gadishullit korean në qendër të vëmendjes. Polemikën në distancë me presidentin Amerikan Donald Trump kanë tërhequr vëmendjen e fuqive më të mëdha të planetit por edhe të njerëzve të thjeshtë të cilët dëshirojnë të mësojnë sa më shumë për vendin më të izoluar të planetit. Ashtu si në çdo fushë tjetër të jetës edhe në sport, situata është shumë e ndryshme nga ajo që përjetojmë normalisht.

Nuk janë të pakta rastet kur regjimi i ka dënuar ashpër sportistët pas dështimeve në arenat ndërkombëtare dhe një i tillë është edhe izolimi i të

Australianani rrëfen futbollin në vendin më të izoluar



gjithë kombëtares së futbollit pas dështimit të turpshëm në Kupën e Botës 2010. Situata nuk ka ndryshuar aspak sepse edhe në ditët e sotme, një profesionist e ka shumë të vështirë të luajë në vendin komunist. Një rrëfim të çmuar për atë që ndodh në Korenë e Veriut e jep lojtari australian Erik Paartalu, i cili është pjesë e skuadrës indiane të Bengaluru FC. Ai udhëtoi bashkë me ekipin e tij drejt vendit komunist për gjysmëfinalen e kupës AFC në 25 prill. Pasi

doli nga hoteli në Phongiang ditën e ndeshjes, Paartalu mësoi për lëshimin e një rakete mbi ishullin japonez të Hokaidos, një situatë surreale. "E pamë shumë mirë trajektoren e raketës mbi qytet", rrëfen lojtari 33-vjeçar që sjell një dëshmi autentike. Në vijim ai shton se ky moment e shokoi skuadrën, madje shumë lojtarë kërkuar të largoheshin menjëherë nga ai vend që Paartalu, e quan të mallkuar. Në vijim të rrëfimit për "CNN", lojtari australian me një

eksperiencë të madhe ndërkombëtare shton se lojtarët koreano-veriorë janë profesionistë të vërtetë për atë që mund t'u lejojë regjimi. "Në përfundim të ndeshjes njëri prej tyre erdhi dhe më uroi për fitoren", shton 33-vjeçari. Një histori që shkëput një pjesë të jetës së vështirë dhe pengesave që has edhe futbollit në vendin më të izoluar të planetit, por ky sport gjithsesi e ka fuqinë për të bashkuar popujt, pavarësisht dëmeve që mund të shkaktojë politika.



Ish-kampioni Kruz rikthehet në UFC 219

UFC ka shpallur dy ndeshje spektakolare për natën finale të vitit. Ish-mbreti i peshës bantam Dominik Kruz do të rikthehet pas një viti pushim teksa Francis Ngannou do të ndeshet ndaj kandidatit numër një Alistair Overeem. Kruz nuk ka luftuar që prej 30 dhjetorit kur u mposht nga Kody Garbrandt dhe do të rikthehet ndaj Rivera. "EL Terror" Rivera po kalon një ecure fantastike me 20 fitore radhazi dhe nuk ka humbur një ndeshje që prej vitit 2008. Kruz do të mundohet të rikthejë lavdinë e dikurshme në UFC pasi u mund rëndë nga Garbrandt. Fituesi i Kruz-Rivera do të vendosi sfiduesin e ri për titullin kampion. Lufta mes Kruz-Rivera zhvillohet sonte (e shtunë) në "T Mobile Arena" në Vegas.

Publicitet

Në pajtim me Vendimin e Këshillit të shkollës për grumbullimin e ofertave për ushqim, Vendimit të KSH për grumbullim të ofertave për ekskursionet e nxënësve, Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shollave fillore, Programin vjetor për punë të Shkollës për vitin shkollor 2017/2018 numër 01-165/1 të datës 18.08.2017 dhe Lejes nga BZHA nr. 09-12/259 të datës 22.09. 2017, SHFK Krume Kepeski – Kisella Vodë, Shkup, publikon

SHPALLJE

Për grumbullim të ofertave për ushqim dhe grumbullim të ofertave për ekskursionet për nxënësit

1. Grumbullimi i ofertave për ushqim:

Së bashku me ofertën duhet të parashtrihen dokumentet në vijim:

- Dëshmi për bonitet nga Regjistri qendror
- Dokument për veprimtari të regjistruar nga Regjistri qendror (subjektet juridike)
- Leje nga organi kompetent për punë (kryerje të veprimtarisë për subjektet fizike)
- Vërtetim se nuk është hapur procedurë falimentimi ose likuidimi
- Garanci bankare për realizim kualitativ të marrëveshjes në shumë prej 5%

Dokumentet nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj, të parashtrihen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter në arkivin e shkollës me shenjë deri tek komisioni në lidhje me ushqimet.

2. Grumbullim të ofertave për ekskursionet e nxënësve:

- Ekskursion treditor për klasën e nëntë nëpër R. Maqedonisë
ruga: Shkup – Tetovë – Gostivar – Mavrovë – Dibër – Strugë – Ohër – Krushevë – Prilep – Shkup
(Me vizitë gjatë rrugës të Vrutokut, Mavrovës, Sv. Jovan Bigorski, Banja Kosovrasti, Hidrocentralet Shpile dhe Gllaboçica, Vevçani, Strugë (Lumi Drin, ura e poezisë), manastiri Shën Naumi, Lagjia në Gradishtë, Çarshia e Ohrit, Pllaoshnik dhe Kaneo, shtëpia e përhershme e Toshes dhe shtëpia përkujtimore, Meçkin Kamen) termini: muaji tetor 2017, akomodim në hotel në Ohër.
- Ekskursion dyditor për klasën e gjashtë nëpër R. Maqedonisë
ruga: Shkup – Strumicë – Dojran – Shkup (me vizitë gjatë rrugës së ujëvarave të Smollarit, manastirit Sv. Leontij – Vodoça, lokalitetit arkeologjik Stobi) termini: muaji prill – maj 2018, akomodim në hotel në Dojran.
- Ekskursion njëditor për klasën e tretë në Krushevë.
- Mësim në natyrë për klasën e pestë – Shkup – Veles – Kavadar – Shkup (vizitë të fshatit Vatasha, Liqenit të Tikveshit, HEC Tikvesh, karakollit në afërsi të pushimores, qytetin e Kavadarit (çarshia, muzetë lokal, konstrukt përkujtimor, Fabrika Kozhufçaka, baseni i peshqve dhe depoja e verës Tikvesh) oferta për 5 ditë, termini: muaji maj 2018, pushimorja Mihajllovo – Kavadar.
- Oferta për piknikë edhe atë në destinacionet në vijim: Pelenica, Manastiri i Markos, Saraj, Banja e Katllanovës, Hipodromi, Vodno, Delladrovci, Çardak, Kondovë.
- Aktivitete jashtëmësimore – pushim dimëror për nxënësit e klasës prej VI-IX, vendi: pushimorja për fëmijë "Shula Mina" në Krushevë, termin: janar 2018 (gjatë pushimit dimëror), shtatë ditë/gjashtë pansione të plota.
- Aktivitete jashtëmësimore – pushime verore për nxënësit e klasës prej VI-IX, vendi: pushimorja për fëmijë "Radosti" në Ohër, termin: qershor – korrik 2018 (gjatë pushimeve verore), shtatë ditë/gjashtë pansione të plota.

Kushtet e nevojshme: udhëtim me autobus turistik, sigurim, mjek, meny për ushqimin, pararezervim ose marrëveshje me objektet për akomodim për periudhat e dhëna, licencë për veprimtari turistike (të vërtetuar me vulë, nënshkrim dhe të besueshëm nga origjinali), dëshmi për tri ekskursione të përfunduara me sukses në tri vitet e fundit, çmimi individual dhe i përgjithshëm për (transport, akomodim dhe ushqim). Të përmbushin kushtet për transport të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri dhe komunikacion.

Shpallja zgjatë 5 ditë nga dita e publikimit të saj.

SHFK Krume Kepeski - Shkup

Hamilton pret reagim të fortë nga Fettel

Piloti britanik, Luis Hamilton, pret që rivali i tij më i afërt për titull, Sebastian Fettel, të kthehet fuqishëm dhe të luftojë, ndonëse mori një goditje në garën e fundit në Singapor. Hamilton ka krijuar një epërsi prej 28 pikëve në krye të renditjes në Formula 1 kur kanë mbetur edhe gjashtë gara deri në fund të stinorit,

pra janë maksimalisht edhe 150 pikë në lojë, transmeton koha.net. "Pilotët e mëdhenj zakonisht rikthehen furishëm, kësh-tu që e llogaris se ai do të kthehet më i fortë se kur-rë më parë", ka thënë Hamilton. "Nuk e mbaj në mend herën e fundit që e kam parë duke rënë në presion. Nuk e di nëse ndien presion ai".



Interi dëshiron të qëndrojë në "San Siro"

Drejtori i Interit, Alessandro Antonello ka pohuar se klubi "Nerazzur" dëshiron të qëndrojë në "San Siro", pasi sipas tij ky stadium është portreti dhe shtëpia e tyre. Ka pasur bisedime për Interin dhe Milanin duke i dhënë fund pjesës së tyre historike në të ardhmen e afërt, por Antonello e bëri të qartë se "Nerazzurët" nuk do të largohen së shpejti nga

ky stadium. Ideja e drejtuesve të Interit është që të qëndrojnë në "San Siro" apo siç njihet nga ta "Giuseppe Meazza", pasi ky stadium do të thotë shumë për ta. "Ne do të takohemi me Milanin dhe me kryetarin për të kuptuar të ardhmen e San Siro", ka thënë fillimisht Antonello për "Inter Media House", platforma e re e përmbajtjes së klubit. "Ne duam të qëndro-

jmë aty, për ne është portreti dhe shtëpia jonë".

Megjithatë, Antonello bëri një kërkesë kur u pyet për rinovimet e mundshme. "Unaza e tretë [e stadiumit] duhet të konvertohet në fushë të mikpritjes", përfundoi drejtori i Interit. Milani ishte klubi i parë që hyri në stadium në vitin 1926, para se Interi ta ndiqte atë 21 vjet më vonë.





Dëmtimet, debutimi në "Camp Nou", paraqitja shumë e mirë kundër Fiorentinass dhe aktivizimi kundër Olimpiakos, për shkak të dëmtimit të Pjaniç. Boshnjaku është ndalur, duke i dhënë një mundësi uruguaiianit: rruga e ngjitjes kalon nga kjo periudhë

Juventus ka një yll të ri, një talent premtues për futbollin italian dhe jo vetëm. Këtë vit ka zbankuar në Torino dhe ka ndërmend të qëndrojë atje për një kohë të gjatë. Quket Rodrigo Bentankur, është 20 vjeç, por luan si një veteran. Kur ka shkuar në Vinovo mendohej se do të kishte qenë vetëm një kalimtar, i konsideruar shumë i ri dhe i papërshtatshëm për Serie A. Më mirë të huazohet? Jo. Ai ka qëndruar në Torino, për t'u rritur, por edhe për të luajtur disa minuta dhe ndoshta më shumë. Dëmtimet, debutimi në "Camp Nou", paraqitja shumë e mirë kundër Fiorentinass dhe aktivizimi kundër Olimpiakos, për shkak të dëmtimit të Pjaniç. Boshnjaku është ndalur, duke i dhënë një mundësi uruguaiian-

Dëmtimi i Pjaniç, mundësi e artë për talentin bardhezi



it: rruga e ngjitjes kalon nga kjo periudhë. Kundër Fiorentinass ka qenë një provë pozitive, por kundër Olimpiakos ka ardhur konfirmimi i papritur. Pa përgatitjen e duhur fizike dhe psikologjike është futur në lojë

në vend të një Pjaniç që është ndalur gjatë nxehjes, por ka qenë gati. Publiku e ka brohoritur ne çdo prekje të topit, ai ka vrapuar dhe ka luftuar për çdo top. I vetmi problem, siç ka theksuar edhe Allegri, janë ver-

tikalizimet. Por është një lojtar i ri, i cili duhet të tregojë se ka personalitet. Si? Duke luajtur. Me topin mes këmbëve duhet të rrezikojë më shumë. Ndeshjet e radhës do të jenë kundër Atalantas, Lazios dhe Sportingut. Do të luajë të paktën një nga këto ndeshje, ndoshta dy ose tre, do të varet nga koha e rikuperimit të Pjaniç, që është shumë i rëndësishëm për Juventus, por që falë Bentankur mund të ketë më shumë kohë në dispozicion për të pushuar dhe për të qenë në maksimumin e formës në fundin e sezonit. Rodrigo ka bërë për vete publikun, Alegri e vlerëson shumë dhe tani do të ketë 90', 180' ose 270' për të bërë për vete Juven, për të qenë protagonist në "Allianz Stadium", siç ishte në "Bombonera" me Boka Juniors.

Rrëfëhet presidentit i Bajernit Uli Henes

Ançeloti kishte 5 senatorë kundër tij!

Presidenti i Bayern Munich, Uli Henes, në një prononcim për 'Funke Sport' deklaroi se një është arsyeja e dështimit të trajnerit italian Karlo Anceloti në drejtimin e gjigantit gjerman, por që e bënte të pashmangshëm largimin e tij. "Ançeloti kishte pesë futbolistë kundër tij dhe kjo ishte e papranueshme. Në cilësinë e trajnerit nuk mund të kesh kurrë kundër teje futbollistët më të mirë të ekipit. Në jetën time kam mësuar një shprehje: armiku në krevatin tënd është më i rrezikshmi. Kjo është arsyeja pse ishim të detyruar të merrnim masa", deklaroi presidenti i Bayern Munich, Uli Henes. Një krizë në kampin e kampionëve të



Gjermanisë dhe mbi të gjitha në dëm të trajnerit italian Karlo Anceloti, që shpërtheu pas humbjes së pësuar në transfertë ndaj PSG, me rezultatin përfundimtar 3-0 në favor të francezëve. Pavarësisht disfatës së thellë,

vetë trajneri Anceloti nuk shfaq asnjë shenjë pendese në lidhje me vendimin e tij për të lënë në bankinë yjet e Bayern Munichut, Ribery, Roben, Humels dhe Boateng, teksa deklaroi: "Nuk pendo hem për asgjë!".

Nëntë mln euro bonus për të nënshkruar para-kontratë

Paris Sen-Zhermen nuk po qëndron duarkryq pasi ka lëvizur në drejtim të një sulmi të ri ndaj Manchester Sinit, për të siguruar shërbimet e sulmuesit të Arsenalit, Aleksis Sançez. Repreruesi i Kilit është jashtë kontratës në qershor të vitit 2018 dhe po refuzon të nënshkruajë një marrëveshje të re me Topçinjtë. Siti janë konsideruar si favoritë për të transferuar Sançezin, por në ditën e fundit të afatit kalimtar të trans-



ferimeve dështoi materializimi i tij. Sipas mediumit "El Mercurio", PSZH tani janë në kontakt me kilianin për një

ofertë para-kontratë, e cila përfshin një nënshkrimi masiv me pagesë. PSZH është e gatshme t'i paguajë Sançezit një bonus kesh me një vlerë prej nëntë milionë eurove nëse ai kryen një kontratë para-prake në muajin janar. Megjithatë, për momentin, Aleksis ende po favorizon një lëvizje në Siti në vitin 2018. Kjo vjen pasi sulmuesi i Arsenalit dëshiron të punojë përsëri me ish-trajnerit e tij të Barcelona, Pep Guardiola.

Shkurt

Ghoulam drejt rinovimit me Napolin

Duket se do të marrë fund telenovela e Faouzi Ghoulam me Napolin. Siç raportojnë mediat italiane, është gjithçka gati për rinovimin e lojtarit me të kaltërit. Kohëzgjatja e marrëveshjes së re do të jetë deri në vitin 2022, teksa do të përfshijë edhe një rritje page nga 800 mijë Euro në sezon deri në 2.5 mln euro. Në kontratën e re do të ketë një klauzolë të dyfishtë, me shifrën që do të variojë nga klubi i interesuar për lojtarin.

Gabigol përleshet me bashkëlojtarin e tij

Lojtari në pronësi të Interit, Gabriel Barbosa i njohur si Gabigol thuhet se ishte përfshirë në një grindje me një shok skuadre te Benfica në prag të disfatës 5-0 të së martës në Bazel. Një video e lëshuar nga transmetuesi portugez "RTP" tregon pamjet ku Gabigol shihet duke u përleshur me mbrojtësin Zhar-el, i cili është edhe bashkëkombës i tij. Nuk dihet arsyeja e përleshjes së dy lojtarëve të Benfikas, por u desh intervenimi i bashkëlojtarëve për t'i ndarë. Benfica ka humbur tre nga pesë ndeshjet e fundit, ndërkohë që 21-vjeçari ka dështuar të shënojë në tri paraqitje për Shqiponjat që kur u bashkua me huazim nga Interi. Përleshja e tyre thuhet se ka ndikuar në paraqitjen e dobët të skuadrës së madhe portugeze, në humbjen e thellë 5-0 nga Bazeli. Drejtuesit e klubit po mendojnë të marrin masa për dy futbollistët, të cilët pritet t'i marrin dënimet brenda kësaj jave.

FIFA dënon Allin me një ndeshje


FIFA ka dënuar Dele Allin me një ndeshje pas gjetit që e bëri në fitoren e Anglisë kundër Sllovakisë me rezultat 2 me 1. Allin ngriti gishtin e mesëm ndaj bashkëlojtarit të tij Kyle Walker derisa menaxheri Gareth Southgate e ftoi 21-vjeçarin për dy ndeshjet e mbetura të eliminatorëve të Botërorit. Mesfushori do të mungojë në ndeshjen kundër Sllovenisë

Barcelona rivalizon Realin për Vernerin

Gjiganti spanjoll, Barcelona i është bashkuar interesimit në sulmuesin e talentuar gjerman të RB Leipzig, Timo Verner. Talenti gjerman ka pasur një sezon fantastik vitin e kaluar duke shënuar shumë gola dhe dhuruar asistime për bashkëlojtarët. Ndeshjet e mira të tij bënë që Verner të ftohet nga kombëtarja e Gjermanisë, ndërsa skuadra të mëdha si Liverpool dhe Real Madridi i vunë pas tij. Sipas "El Mundo Deportivo", Barcelona është gjithashtu e interesuar, pasi ka shtuar Vernerin në një listë të ngushtë të sulmuesve, pasi kërkojnë të mbulojnë Luis Suarezin. "Unë jam i lumtur në Leipzig dhe kur jam në fushë mendoj vetëm për Leipzig. Tani për tani nuk po mendoj për Real Madridin apo ndonjë klub tjetër, por natyrisht më bën të lumtur të lexoj se Real Madridi është i interesuar për mua. Do të ishte një gjenjeshër të thuhet se nuk më intereson", ka thënë Verner.

Interi planifikon transferimin e Pastores

Mesfushori argjentinas i Paris Sen-Zhermen, Javier Pastore thuhet se është subjekt i interesimit të gjigantëve italianë, Interit, të cilët duket të vazhdojnë ringjalljen e tyre si një nga skuadrat më të mira evropiane. Siç raportohet nga "TalkSport", 28-vjeçari argjentinas ka gjasa të kërkojë një largim nga Parisi pasi ata e forcuan skuadrën e tyre me Nejmarin dhe Kylian Mbappen këtë verë. Me një bollëk të talenteve në mesfushë dhe në vijën sulmuese, Pastore mendon se së



shpejti do të bëhet një rezervistë i "përbetuar". Edhe mediumi italian "SportMediaset", raportoi se Interi po planifikon një lëvizje për ish-mesfushorin e Paler-

mos, i cili ka kaluar gjashtë vjet në "Parc des Prince's", që prej lëvizjes së tij prej 39.8 milionë eurosh në vitin 2011. Interi thuhet se ka planifikuar një ofertë për janar në drejtim të argjentinasit, me Çellsin dhe Liverpoolin që gjithashtu thuhet të jenë admirues të mesfushorit padyshim të talentuar. Pas arrijtes së transferimit rekord të Nejmarit në verë nga Barcelona, Pastore e mirëpriti brazilianin duke ia dorëzuar fanellën e tij me numrin 10. Ndonëse ishte një veprim shumë sportiv, nuk

ka dyshim, janë ngritur pyetje nëse Pastore është i kënaqur me jetën në kryeqytetin francez që kur PSZH kanë ngritur projekte të reja për dominimin e futbollit. Përveç kësaj, PSZH do të dëshirojë të largojë disa lojtarë për të përmbyshur rregullat Financiare të "Fair Play" pas shpenzimeve të shumta në verë, kështu Pastore mund të jetë fillimi i eksodit nga Parisi. Pastore ka luajtur 346 ndeshje për Parisianët, duke regjistruar 67 gola dhe 69 asistime deri më tani.



Dua të mendoj vetëm për ndeshjet. Rreth kësaj teme kanë folur shumë sportistë por unë i gjykoj futbollistët për atë që japin në fushën e lojës dhe të mos kenim asnjë dyshim që një gjë të tillë do ta bëj edhe me Piken. Nuk do të lejoj që askush të na nxjerrë nga rruga që kemi nisur. E kam lexuar atë që ka thënë Ramos dhe mendoj se nuk ka asnjë problem në këtë mes

Dështimi i Bonuçit, mbrojtja “horror” dhe problemet e vërteta të Milanit

E paimagjinueshme për një skuadër që synon të kthehet në majat e futbollit kombëtar dhe ndërkombëtar, veçanërisht pas një jave të mbushur me kritika dhe vendime të diskutueshme. Milani ka investuar shumë në repartin e mbrojtjes gjatë verës. Duhet të ishte reparti që do të bënte diferencën. Por nuk ka ndodhur, në këtë moment është një nga problemet kryesore të skuadrës



Gjërat nuk po shkojnë mirë për Milanin. Në ndeshjen kundër Rijekas e vetmja gjë pozitive ka qenë rezultati, që i mban kuqezinjtë në kreun e Grupit D të “Europa League” me pikë të plota. Dy gola avantazh me sforcim minimal para amnezisë të pabesueshme në minutat e fundit, me kroatët që kanë arritur të barazojnë. E paimagjinueshme për një skuadër që synon të kthehet në majat e futbollit kombëtar

dhe ndërkombëtar, veçanërisht pas një jave të mbushur me kritika dhe vendime të diskutueshme. Milani ka investuar shumë në repartin e mbrojtjes gjatë verës. Duhet të ishte reparti që do të bënte diferencën. Por nuk ka ndodhur, në këtë moment është një nga problemet kryesore të skuadrës. Gabime individuale të njëpasnjëshme, humbje të përqendrimit të dukshme. Nga Zapata te Romanjoli dhe deri te Bonuçi, të gjithë kanë

dhënë një kontribut negativ. Pikërisht ish-juventini është zhgënjimi më i madh. Gafa në rastin e golit të parë të Rijekas është një përmbledhje e momentit që ai po kalon. Largimi i përgatitësit atletik Marra ka qenë në qendër të vëmendjes së shtypit para ndeshjes. Është shumë e çuditshme të largosh përgatitësin atletik në shtator. Milani mund të mos jetë në formë shumë të mirë fizike, por duke parë paraqitjen e

bërë në “Europa League”, duket se është vetëm një nga aspektet negative. Montella ka shumë punë për të bërë, skuadra e tij nuk ka akoma një identitet dhe jo stil të qartë loje. Kundër Romas do të duhet të vijë një ndryshim i marshit, sepse një tjetër hap i gabuar mund të ketë një ndikim të rëndë te ky grup, që është dukur i bashkuar por që ka bërë disa gabime amatoreske në aspektin e përqendrimit dhe të urisë për fitore.



Morata: Konte beson tek unë, mund të jap më të mirën

Alvaro Morata lavdëroi trajnerin e Çellsit, Antonio Konte, pasi sulmuesi shënoi një gol jetik ndaj Atletico Madrid, në Ligën e Kampioneve, të mërkurën. 24-vjeçari u bashkua me Çellsin për 55 milionë £ në verë dhe ai u takua me “kryqin” e Eden Hazard për të shënuar golin e tij të shtatë në shtatë ndeshje për klubin londinez. Ish-sulmuesi i Real Madridit festoi barazimin e tij me Konte. Miçi Batshuaqi më pas hyri në vend të Morata dhe shënoi golin e fitores në minutën e 94-t. Morata është mirënjohës që lëvizja e tij në Londër është kthyer plotësisht, pas humbjes së një penallti në një disfatë kundër Arsenalit, në “Community Shield”. “Unë erdha te Çellsin, sepse një klub dhe një trajner besonin tek mua. Tani kam të gjitha këto gjëra dhe jam shumë i lumtur. Ndeshjen e parë zyrtare kam bërë një gabim dhe e kam vuajtur për disa ditë. Njerëzit nuk e shohin situatën, por unë rritem, nxjerr karakterin tim dhe tani gjërat janë në rregull. Premier Ligë është fizike, një ligë me ekipet më të mëdha, që mund ta fitojnë titullin. Jam shumë i lumtur, jo vetëm për mua, por për të gjithë ekipin”, thotë Morata. “Nivelin e Çellsit e panë të gjitha ekipet evropiane. Atletico Madrid gjithmonë lufton për titullin, por ne i morëm tri pikët, ndaj jemi shumë të lumtur. Po luftojmë edhe në Premier Ligë, gjithashtu, kemi një tjetër ndeshje të madhe kundër Manchester Sitit më pas. Kjo supersfidë është shumë e rëndësishme për ne, përpara se të ndërpritet aktiviteti nga kombëtarët”, nënvizoi mw tej sulmuesi spanjoll. Çellsin luajti me dy sulmues në Madrid, pasi Konte e studio me mirë Diego Simeone taktikisht gjatë natës. Konte zgjodhi të rreshtonte me Moratën edhe Eden Hazard, duke udhëhequr repartin ofensivë, ndërsa spanjollin ndërkombëtar përshëndeti kinë dhe tij në fushë me shokun e skuadrës: “Nuk është e vështirë të luash me këtë lloj lojtari. Hazard është një nga tre lojtarët më të mirë në botë. Është e lehtë për mua të luaj me të”, përfundoi Alvaro Morata.

Ben Arfa denoncon PSZH për ngacmim dhe diskriminim

Ndarja mes Ben Arfa dhe Paris Sen ZHermerit është një sekret pas kësaj vere, sepse nuk ka arritur një marrëveshje për largimin e tij nga klubi. Unai Emery kurrë nuk i ka besuar atij. Dëshmi për këtë është se ai nuk e ka marrë sulmuesin në Ligën e Kampioneve dhe në javët e fundit është trajnuar me ekipin rezervë. Sulmuesi francez, me origjinë tuniziane ishte shembullor gjatë ditëve të para. Por mjedis i futbollit ka ndezur atmosferën në javët e fundit dhe kërcënon publikisht me një padi, nëse PSZH nuk e lejon të stërvitet përsëri me ekipin e parë. Këtë të enjte, ai u kthye në ekipin e rezervave. Avokati i Ben Arfa ka vendosur të



kundërsulmojë dhe ka raportuar incidentin tek komiteti ligjor i LFP-së. “Kemi parashtruar ankesë për diskriminim ndaj lojtarit në ambientin e tij profesional. Metoda e përdorur për një rast të tillë është psikologjike. Të martën i kërkuan atij të stërvitej me rezervat, në

mënyrë që të mos shqetësojë kundër Bajern Munihi. Hantem kuptoi. Dje (e enjte), ai u kthye me ekipin e parë pa ndonjë shpjegim. Ajo që ishte një masë e përkohshme është maskuar në diçka të përhershme.” – i tha ai “L’Equipe”.



“Homazhi” i pazakontë, 300 topa për Lionel Messin

E përditshmja katalanase, “Sport”, kishte filluar të mendonte në lidhje me atë që ishte mënyra më e mirë për t’i bërë një “homazh” Leo Messit për 300 golat e tij në “Camp Nou”. Tomàs Andreu, më në fund doli me idenë e sjelljes së 300 topave, që do të përfundonin bashkarisht në një gol. Dukej e pamundur kjo nismë, sepse kishte vetëm pak ditë në dispozicion. Thënë ndryshe, kishte ardhur koha të zbrisnin të gjithë në punë. Dyqani i futbollit “Emotion” në lagjen Born të Barcelonës u premtoi iniciatorëve se mund t’u jepnin 300 topa nga depoja e tyre në Zaragoza. Gjëja e parë ishte të mendohej për transportin nga kryeqyteti aragonez. Procesi i parë u përbush pa shumë probleme. Janë mbushur 17 kuti me topa “Adidas” dhe janë futur në një furgon. Tre personat përgjegjës shpenzuan një pasdite me kompresor, për t’i fryrë 300 topat. Ata ishin, gjithashtu, përgjegjës për transferimin e topave herët në mëngjes në “Ciutat Esportiva Joan Gamper”. Takimi me Messin ishte rreth orës 10:15 të mëngjesit, pasi trajnimi fillonte në orën 11:00. Pak para orës tetë të mëngjesit, furgoni hyri në objektet e “Ciutat Esportiva”, pas kalimit të kontrollit të detyrueshëm të sigurisë. Në orën 09:15, fotografët kishin organizuar tashmë të gjithë materialin dhe filluan të testonin kamerat, të kontrollonin dritën dhe fotografonin fotot e provës. Messi u shfaq në 10:08 minuta, duke qeshur dhe i relaksuar. Argentinasi ishte i befasuar për të parë topa kaq shumë së bashku, nënshkroi disa autografe dhe shkoi në dhomat e zhveshjes për të përgatitur trajnimin. Në fund të seancës, vetëm kamera e Valenti Enrih kishte ruajtur 258 foto, mes testeve dhe vetë seancës.

Kavani dhe Nejmar bëjnë paqe nga halli

Paqe? Jo, më shumë një armëpushim. Mes Kavani dhe Nejmar nuk ka harmoni, kjo është e qartë. Është parë qartë në kampionat, ndërsa ka pasur një tentativë për ta maskuar në ndeshjen e “Champions League” të fituar 3-0 kundër Bajern Munihi. Të dy kanë shënuar, ashtu si Dani Alves, miku i besuar i Nejmar. Në fund të ndeshjes, në mënyrë të tyre, kanë provuar të mohojnë mosmarrëveshjet dhe të qetësojnë situatën, sepse “skuadra vjen para gjithçkaje”. “Kam lexuar shumë shpifje”, – ka




thënë Nejmar për shtypin brazilian. – Flasin për gjëra që nuk i dinë, që nuk ekzistojnë”. Ndërsa, pyetjes në


lidhje me marrëdhënien e tij me Kavanin, braziliani i është përgjigjur thatë: “U përgjigja një herë”. Por më

pas ka ardhur komplimenti për shokun tjetër të sulmit, Kilian Mbappe. “Është një privilegj të luaj me të, duket sikur është 30 vjeç për pjekurinë që ka. Do të jetë një kandidat për ‘Topin e Artë’ në të ardhmen”. Po Kavani? Ka vënë të mirën e ekipit para vetes. Një goditje dënimi e ka goditur ai, tjetër Nejmar. “Jemi ndryshe”, – ka thënë uruguaiasi pas ndeshjes së të mërkurës, – secili ka mendimin e vet, por në fushë duhet të jemi një familje. Kjo është e vetmja gjë që ka rëndësi”, përfundoi Nejmar.


DASHI (20/III-20/IV)

 Do t'iu duhet të qëndroni më gjatë në punës apo një pjesë të saj do ta merrni në shtëpi. Në rast se bashkëpunëtorët iu bëjnë nervoz, mos u zbrazi në ta sepse nuk kanë kurrfarë faj. Nëse nuk keni kujdes çfarë flisni dhe bëni, më vonë mund të keni probleme.


DEMI (21/IV-20/V)

 Vendimi që të pranoni një punë të rëndë honorare do të tregohet e dobishme sepse do t'iu ndihmojë të dilni nga problemet financiare. Një person në pozitë të lartë do të dëshmojë se e vlerëson punën dhe talentin tuaj. Ndryshime të mira iu presin edhe në jetën e dashurisë, mos u bëni skeptik!


BINJAKËT (21/V-20/VI)

 Është e theksuar rëndësia e bashkëpunimit dhe raporteve të mira me kushërinjtë, vëllezërit dhe motrat. Nëse dikush prej tyre është në situatë problematike, ndihma juaj do të ketë rëndësi. Kujdes se me ndonjë kritikë të pamenduar mos t'i lëndoni.


GAFORRJA (21/VI-22/VII)

 Në shtëpinë tuaj do të ndjeheni të inatosur dhe të mërzitur. Do të paraqiten disa mysafirë të pafuar që do t'iu duhet t'iu kushtoni rëndësi. Do të jeni të inatosur sepse duke u marrë me jetën e huaj do të tërhiqeni nga planet dhe punët me miqtë. Përqendrohuni në atë që ka rëndësi.


LUANI (23/VII-22/VIII)

 Do t'iu paraqitet një mik që s'e keni parë kaherë, por shkaku i obligimeve familjare dhe punës do të keni fare pak kohë për të. Nëse dëshironi ta fitoni personin që iu pëlqen, nuk do të mendoheni gjatë. Do t'ia bëni me dije menjëherë se çfarë mund të presë nga ju.


VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)

 Do të diskutoni me miqtë për disa çështje të ndjeshme, por do të ketë edhe gjëra që do t'i heshtni. Jetën private do ta fshihni nga kolegët, e partnerin s'do ta lodhni me problemet në punë. Do të njiheni me dikë që do t'iu tërheq me sharmë të veçantë.


PESHORJA (23/IX-22/X)

 Dikush do t'ua ruaj shpinën dhe do t'iu përkrah në planet tuaja. Do të jeni mjaftë të kënaqur me rezultatet tuaja profesionale, por do të ishte më mirë që të ndani pak kohë edhe për anën më të qetë të jetës. Kohën e lirë shfrytëzojeni për kujdes për vete dhe shoqëri.


AKREPI (22/X-21/XII)

 Nuk do të mund të realizoni idetë tuaja ashtu siç keni planifikuar. Do t'iu duhet të përshatani me të tjerët dhe t'i pranoni disa kompromise. Për t'i qetësuar nervat do t'iu duhet pak pushim, në rrethin shtëpiak vështirë që do të gjeni qetësi. Shëtisni pak.


SHIGJETARI (22/XI-21/XII)

 Situata në dashuri mund të komplikohet shumë. Me ish-partnerin nuk do t'i qëroni krejt hesapet, e do të filloni lidhje të re. Në punë do të veçoheni me imagjinatë dhe kreativitet. Do të merrni një këshillë të dobishme apo rastësisht do t'i kuptoni disa informata të besueshme.


BRICJAPI (22/XII-20/I)


 Detyrave të punës do t'iu qaseni me shumë ambicie dhe elanë. Nëse jeni shef, nuk do të toleroni vonesa, biseda private dhe mungesa të paarsyeshme. Nëse po planifikoni të bëni blerje të mëdha, kryejeni sa më herët, e momentet e lira shfrytëzojeni për ushtrime dhe not.

UJORI (20/I-19/II)

 Në efektin tuaj të punës do të ndikojnë keqkuptimet me disa kolegë dhe raporti i dobët me ta. Shumë energji do të harxhoni në punët e panevojshme. Kritikën dhe sugjerimet e familjarëve gjithnjë do t'i ndjeni si presion të padurueshëm. Miqtë do t'iu disponojnë.

PESHQIT (20/II-19/III)

 Nervozin e brendshëm do të përpigjeni ta mundni me punë të mundimshme. Nëse ndjeni se energjia dhe koncentrimi po iu bien do të jetë më së miri nëse relaksoheni pak për të rimarrë fuqinë. Ekziston mundësia të takoheni me një person që iu pëlqen. I kni pyetjeve intime.

		PJESË E FIZIKËS (shq.)	TEL ME PËRDREDHJE	DETARËT		DOBIA, PROFITI	
				AKTORI ANGLEZ, DALTON		AKTORI AMERIKAN, KERTIS	
	ELEMENT KIMIK RADIOAKTIV (At) (shq.)						
	QË LIDHET ME EPIRIN						
	QYTET NË ITALI						
	EMËR KODRE, MALI OSE BJESHKE						
DITËT E MUAJIT NË KALENDAR (shq.)						INTENSITET	
						KËNGËTARJA JONË, TOSKA	
AKTORJA ITALIANE NGA FOTO		PIQEMI ME MIQ, SHOKË etj.		FIGURË E SHENJTË FEMIJË I VOGËL (I...)	PARA-ARDHËSE E JONË PALËVIZHMERI		AMULLI SHPIRTËRORE, PANDJESI
QË LIDHET ME OSMANËT, OSMANË						NËNA PJESETARE E POPULLSISË TË NJË SHTETI	
FAMILJE E KËRMIJËVE TË DETIT						QYTET NË MAQEDONI	
						I ETERIT (shq.)	
						NATRIUM	
						BANOR I KRYEQYTETIT SHQIPTAR	
NGULJA E PIKETAVE NË TOKË (shum.)							
BASHKËSITË							
A. H.						ITALIA	
						QË UA MBATH KËMBËVE NGA FRIKA	
AKTORJA E VJETËR AMERIKANË, DEJVIS					DËM (vjet.) (shq.)		PËRGËZIMI QË I BËJME DIKJUT NË NJË RAST
					TËRKUZË, KONOP		
LLOJ VERNIKU, SMALTI						FIZIKANI, NJUTNI (shq.)	
						SPORT DIMRI	
TRAJNERI ITALIAN I FUTBOLIT, MARÇELO						BAZË E NJË FILMI	
						LIQË NË AMERIKËN VERIORE	
URAN		QË LIDHET ME MORALIN, E ETIKËS				AKTORJA FRANÇEZE, ZHIRARDO	
		PËRKUL				KYÇ	
KOMANDANTI I NJË ÇETE						KRAHINË NË INDI	
						OKSIGJEN	
NUMËR RENDOR						RRITJA OSE HYRJA E THOIT NË MISH	

SUDOKU

1

E LEHTË

		5				3	8
5	8	7			1		
		2		4	6	5	
8	4			5		1	
7	6			8		2	
3			1			8	6
	5	7					
			5			7	
	1	6		2	8		3

2

E RËNDË

1				9			
4			2		1	7	8
							6
	7			2	9		
				9		2	
	8		4				7
		3			4		5
5				8			6
				5			7
						7	4

Në secilën fushë të zbrazët shkruani nga një numër prej 1 deri 9 në çdo rresht horizontal, kolonë vertikale dhe në secilin nga nëntë katrorët 3x3 duhet të jenë shifrat prej 1 deri 9.

ZGJIDHET: M. F. ASTATI, EPIROT, RIMINI, ORONIM, DATA I, M. T. LIRE, OTOMANE, EMA, NATRKA, SHTIP, PIKETIMET, NA, KOMUNITETET, AH, REKETI, I, BET, ZAFARI, EMALLI ISAKU, LIPI, SKENAR, U, ETIJE, ANI, ÇETARI, ASAN, IPARI, ONIKI, SUOAKU, I, 479 521 639, 568 739 142, 132 846 597, 824 365 719, 716 498 325, 393, 217 486, 257 183 964, 683 954 271, 941 672 853, 2) 168 579 432, 435 261 789, 297 348 561, 674 818 12 953, 351 796 248, 982 435 617, 713 624 895, 549 187 326, 826 953 174.

Kina i refuzon vizën një atleteje indiane 101-vjeçare

Në moshën 101-vjeçare, indiania Man Kaur ëndërronte të merrte një medalje tjetër ari gjatë Lojërave aziatike të Mjeshtrave, por ëndrra e saj u thye, pasi Kina refuzoi t'i jepte vizë, bën të ditur AFP. Man Kaur, fituese në muajin prill në Auckland e titullit të 100 metrave në kategorinë e 100-vjeçarëve gjatë Lojërave Botërore të Mjeshtrave, ishte stërvitur prej shumë kohësh për të marrë pjesë në kompeticionin që zhvillohet në Rugao, në lindje të Kinës. "Jam shumë e dëshpëruar që m'u refuzua viza", tregon ajo. "Kudo ku ne shkojmë, kthehemi me fitore dhe



këtë herë kisha besim se do të fitoja", shtoi ajo. "Por, ky nuk është fundi. Do të vazhdoj të stërvitem dhe do të marr pjesë në lojëra të tjera", nënvizoi ajo. Kaur, e cila e ka filluar atletikën në moshën 93-vjeçare, do të merrte pjesë në Rugao në garat 100 dhe 200 me-

tra. "Ne kemi udhëtuar kudo në botë, nga Anglia në SHBA duke kaluar nga Zelanda e Re, kurrë nuk na është refuzuar viza", deklaroi Gurdev Singh, djali i saj 79-vjeçar. Man Kaur, e ashtuquajtur "mrekullia e Chandigarh", emri i metropolit të veriut të Indisë, ku 100-vjeçarja ka origjinën, është një prej personave të zgjedhur për çmimet prestigjioze "Laureus Awards" në kategorinë "Momenti më i mirë sportiv i vitit". Ajo vrapoi në muajin prill një 100 metërsh në 1'14", rreth 64 sekonda më shumë se rekordmeni i botës, xhamajkani Usain Bolt.

Këshilltari i Trumpit i regjistruar për të votuar si grua!

Jared Kushner, dhëndri dhe këshilltari i lartë i presidentit amerikan, Donald Trump, ishte regjistruar për të votuar si grua në listat zgjedhore për tetë vjet, njoftoi media amerikane. "Dokumentet informative zgjedhore të mbajtura nga shteti i Nju Jorkut tregojnë se këshilltari në Shtëpinë e Bardhë, misionet e të cilat do të jenë nga kërkimi i paqes në Lindjen e Mesme deri te lufta kundër analgjizikëve në SHBA, ka qenë i regjistruar si grua për të vo-



tuar", zbuloi e përjavshmja "Wired". Para vitit 2009, profili i zgjedhësit të Kushner në Nju Xhersi jepte gjiminë e tij si i panjohur, sipas faqes informative "The Hill". Ky nuk është kamufli i parë administrativ, në të cilin është përfshirë Jared Kushner, trashëgimtar i një familjeje të pasur pronarësh. Në muajin janar "Washington Post" njoftoi se ai ishte regjistruar në të njëjtën kohë në listat zgjedhore të dy shteteve amerikane gjatë zgjedhjeve të vitit 2016.

ESA: Një fshat i përhershëm në Hënë, hapi i parë drejt Marsit

Ngritja e një "fshati" të qëndrueshëm në Hënë përbën fazën e parë drejt eksplorimit të njeriut në Mars, vlerësoi sot Agjencia Hapësinore Evropiane (ESA). Hëna, e pashkeluar nga një qenie njerëzore prej 1972, është vendi i duhur edhe pse Marsi mbetet destinacioni përfundimtar, theksoi ESA me rastin e kongresit të 68-të botëror të astronautikës që mbledhi bashkë nga e hëna prej së premtes 4.000 ekspertë ndërkombëtarë në Adelaidë,



në Australi. "Ne kemi jetuar në orbitën më të ulët të tokës këto 17 vitet e fundit në bordin e një

stacioni hapësinor dhe po përgatitemi për misionin e parë të njeriut në Mars", shpjegoi për median në

vazhden e kongresit, Piero Messina që punon nën drejtimin e përgjithshëm të ESA. Ndërkohë ne besojmë se ekziston mundësia për të krijuar një prani të qëndrueshme dhe të përhershme në sipërfaqen e Hënës. Për të shkelur dhe populluar Marsin është perceptuar nga kompanitë private dhe publike si një hap tjetër i rëndësishëm në eksplorimin hapësinor dhe është parashtruar si një temë kyçe në kongresin e Adelaide.

Pushohet nga puna sepse lexonte "Mein Kampf" të Hitlerit

Një punonjës i zyrës së një komune në Berlin është shkarkuar menjëherë nga detyra, pasi u gjet duke lexuar librin autobiografik të liderit nazist, Adolf Hitler, "Mein Kampf" (Lufta ime), gjatë orarit të pushimit. Sipas gjykatës lokale për çështjet e punës, shkarkimi i tij ishte ligjërish i vlefshëm. Punonjësi kishte hedhur në gjyq komunën, sepse ai nuk ishte paralajmëruar



për shkarkimin e tij. Kryetari i trupit gjykues bëri të ditur se autorite-

tet shtetërore nuk ishin të detyruara të paralajmëronin punonjës, pas një veprë aq të rëndë dhe se kishin ligjërish të drejtë për ta shkarkuar menjëherë atë. "Punonjësi mban uniformën që përfaqëson Berlinin dhe si rrjedhojë është i detyruar të mbrojë parimet e kushtetutës së lirë demokratike, ashtu siç thuhet edhe në ligjin themeltar gjerman", tha gjyqtari.

KALENDARI HISTORIK 30 SHTATOR

1399 - Mbreti Riçardi II i Anglisë heq dorë nga froni.

1520 - Sulejmani I trashëgon babain e tij Selamin I si Sulltan i Turqisë.



1544 - Mbreti Henri VIII tërheqë ushtrinë e tij nga Franca.

1744 - Franca dhe Spanja mundin Mbretërinë e Sardinias në Betenë e Madonna dell'Olmo.

1791 - Mbahet premiera e operës së Mozartit "Fylli magjik" në Vjenë. 1938 - Marrëveshja e Muniut - detyron Çekoslovakinë të japë territor Gjermanisë. 1939 - Gjermania dhe Rusia merren vesh për ndarje të Polonisë.



1974 - Gjenerali Francesco da Costa Gomez trashëgon Gjeneralin Spinola si president të Portugalisë.

1977 - Për shkak të buxhetit të ulët amerikan, mbyllet pakotja e eksperimentit ALSEP

të lënë në hënë, në kuadër programit Apollo. 1980 - Irani refuzon armëpushimin e propozuar nga kryetari irakian, Sadam Husein.

A E DINI SE...



Bebet që kanë një vëlla apo motër më të madhe janë dy herë më të rrezikuara që të preken nga gripi i rëndë, sipas një studimi. Kjo pasi që fëmijët janë "shpërndarës efikas" dhe mund ta pasojnë lehtë virusin në vëllezërit apo motrat e tyre më të vegjël, tha hulumtimi. Mes 3 dhe 11% të foshnjave dhe fëmijëve në shtetet e zhvilluara preken nga sëmundjet që lidhen me grip çdo vit, duke vënë një barrë të rëndë në shërbimet e shëndetit. Pothuajse gjysma e të gjitha rasteve të gripit të rëndë në bebe nën gjashtë muaj transmetohen nga fëmijët dhe vëllezërit më të mëdhenj, sipas një studimi nga University College London's Great Ormond Institute of Child Health.



BARSOLETA



SHOFERI I KAMIONIT

Ndalet shoferi i kamionit në parking i cili e shef një prostitutë dhe e pyet:

- Hej bukuroshe çka do të kishë bërë për 100 DM?
- Gjithçka do kisha bërë - , thotë prostituta!
- Atëherë hyp lart dhe më ndihmo që ta shkarkoj mallin nga kamioni!, i thotë shoferi i kamionit

THËNIA E DITËS

Askush nuk ka thënë se jeta është e lehtë, kanë thënë vetëm, se ia vlen! (Harvey Mackay)

